

Vlera e njeriut nuk qëndron
në dijen, por në
vullnetin e fortë

HERBART.

Normalisti

Mbrendija

Të mësuesit e gjënavet të njimëndëta dhe kufiri
i tyre.

Mësuesi.

Vajzat në Normale dhe me këtë rasë pakë fjalë
mbi koedukacionin.

Mësimet e Jetës.

Çështje të parrahura.

Të bërit gati të klasës është të domosdoshëm.

Provë Mësimi.

Provë Mësimi.

Provë Mësimi.

Mësuësi i vjetër rrëfëhet.

Një konferencë Pedagogjike.

Nërinë.

Lëvizje Edukative.

Shënimet e Redaksisë.

Mendime, anekdota dhe 4 faqe Folklorë.

Normalisti

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkëncore
DEL NJI HERË NË MUAJ.

E botojnë nxânësit e Normales

Editor: Harilla Kuçuli '37.

Sekretar: Kol Lekaj '37.

Arkëtar: Jovan Gjerga '37.

Ndihmësit

Tajar Reovica '38.

Panajot Foto '38.

Koço Mosko '39.

Drejtimi

E përkohëshmja "NORMALISTI,"

Shkolla Normale

Elbasan

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Pajtimet:

Për mësues

Copa lek 1.25

Për gjithë vitin fr. ar. 1.50

Për nxânës

copa lek 1.

Për gjithë vitin fr. ar. 1.

NORMALISTI

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore

DEL MUAJ PËR MUAJ

E botojnë nxënësit e Normales.

VITI I VIII.

— KALLNDUER 1937 —

Nr. 2

Të mësuemit e gjânavet të njimëndëta dhe kufini i tyre.

Si mbas psikologjisë tëminore, fëmijt e vegjël nuk kuptojnë gjana abstrakte e theorike, ata kuptojnë dhe duen gjana praktike, gjana që mund t'i shohin, t'i ndigjojnë e t'i rrokkin, gjana që kanë lëvizje, ngjyrë e mâ fort jetë. Në qoftë pra se duem të shkojmë mbas natyrës së fëmijvet, nuk duhet t'u shtrojmë këtyne përpara gjana të nalta e të randa, por gjana të lehta e të kuptueshme, gjana të njimëndëta, m: gjallësi e mâ fort **me jetë**. Prandaj theksohet sot prej gjithë metodikanëve se duhet të **nisemi prej jetës** e të **kthehemi prapë në jetë**. Nji nga pedagogët e sotshëm Ernest Linde ka thanë: "**jeta është ajo që edukon**", gjallëni, kjo është fjala që duhet shkruar me shkronja t'arta në derë të çdo shkolle, fjala që në shpirtin e çdo edukatori duhet të qëndrojë si nji shkrim i ndritshëm. Objekti i vërtetë i të mësuemit është v. t. e. jeta; jetë e jo shkencë duhet të shpërnda-

jmë në mësim; pra qëllimi i çdo edukate të fëmisë është jeta e gjallë dhe jo ditunija e gjanë (?).

Prej këtyneve kuptohet se mësuësi landën e mësimëvet duhet t'ua paraqesi e t'ua shtjellojë nxanësve, sa është e mundun, si **realitet a njimëndësi**, duhet t'u paraqisi **jetë**. Mirë po a është e mundun që çdo landë që do t'iu fllëzohet fëmijvet të paraqitet si **realitet a si njimëndësi?** E dijmë se vetëm nji pjesë e landës së mësimit mund t'u shtrohet para nxanësve si nji realitet i gjallë. Le ta zamë p sh se do t'iu mësojmë nxanësve shtazët e vendit të lindjes dhe ato të vendeve të hueja; qenin e macen, kalin a lopën, lepurin, dhelprën, luanin, tigrin, elefantin, krokodilin, etj. Shtazët e shpendët e aërme, uji mace p. sh., nji qen, nji pulë, nji zog mundet me iu shtruar përpara nxanësve si realitet, medjë edhe mbrenda

(1) E. Weber, Unterrichtsgestaltung f. 19

në shkollë. Ka in e lopën, delen e dhinë nxanësit mund ta gjëjnë e ta shohin në një grazhd, në një kasollë ase në rrugë Puna është e vështirë për shtazët e egra të pyllit, si për uj-kun, dhelprën, ariun dhe krejt e pamundshëm për shtazët e egra të hueja, si për luanin, tigrën, elefantin, etj. Gjithashtu mund të thohet edhe për bimët t'ooa e të hueja. Asht e ditun se këto mund të verohen nëpër kopshtet e muzetë zoologjike, nëpër acquaria, etj., sikurse kanë të tilla qytetet e mëdha t'Europës. Edhe n'ato vise ku ka të tilla Institute, nxanësit nuk mund të fitojnë një intuitë reale, se këto nuk iu paraqiten në rrethin e tyre të natyrshëm, në jetën e tyre të vërtetë.

Për sa u përket shtazcvet të mbushuna që gjinden nëpër muzetë zoologjike a të mjetevet të mësimit që mund të ketë çdo shkollë, këto janë mjete të mira, për me bërë një mësim në mënyrë logjike e shkencore; mirë po këto mbesin gjithënjë një gjë e vdekun dhe e thatë, kurse fëmijët duen jetë, jetë plot me shëndet e me gjak. Le ta zamë prapë se duhet t'u mësojmë nxanësvet historinë e Ilirianëve a të Skënderbeut, historinë e gjeografisë e Ballkanit, Alpet, Afrikën, Europën, Azinë ndonji kështjell të vjetër, luftat e Grekëve e të Romakëve, etj. Për këto mësimë kishim me përdorë hartat gjeografike e historike ose ndonji mjet tjetër mësimi mbi armat e veshjet e vjetra e mbi banimin e jetesën e të vjetërve. Po të gjitha këto kishin me e paraqitë landën e mësimi vërtet intuitive, por jo gjithë **jetë** e **gjallëni**, sikurse kërkon metodika

e re sotshme.

Kuptohet pra prej këtyneve se vetëm një pjesë e landës së mësimi mund t'iu paraqitet nxanësvet si një realitet i gjallë. E tanë bota e largme e vendit dhe e kohës kishte me u përjashtue atëhere nga mësimi. Kjo botë e largët pra e kohës dhe e vendit, të cilës nuk mund t'ja mrrimë e ta bëmë reale, si mundet të hyjë në shpirtit të fëmijvet t'onë?

Vetëm një mjet është i posaçëm për këtë punë; këtë mjet nuk na e jep as shkenca, as abstraksioni logjik, por vetëm **arti**, thotë Ernest Weber i. Në qoftë se arti nuk mundet me na dhanë realitetin, njimendësinë në kuptimin e vërtetë të fjalës, por së paku na jep dukjen e përjashtme a formën e realitetit dhe të gjallësisë, jo atë të abstraktit, por të **individualit**, na jep me mijëra mënyrë e variacione. Vetëm arti mund të na japë çka nuk mundet me na dhanë gjithë shkencat: **jetë**, jetë të pasun, të zjarrtë, gufmuese, plot me ngjyrë e me shkëlqim. Këtë jetë e gëjmë në kallzimet e bukura në prozë a në poezi, të hartueme prej auktorësh që dijnë të shkruajnë ambël e bukur. Të panjehuna janë shkrimet e tilla në pjuhët e hueja. Me shumicë janë auktorët që kanë hartue në këto gjuhë kallzime në prozë a në vjershë mbi shtazë, bimë, vise, ngjarje, udhëtime e të tjera. Këto nuk janë kallzime në një formë shkencore e logjike, por **individuale**, të rrjedhshme e të gjallë, si me e pasë para-sysh gjësendin të cilin kallzon auktori. Në këtë formë e mënyrë shkrimi janë trajtue landë të ndryshme si prej historisë së natyrës, ashtu edhe prej gjeografisë.

historisë, moralit, bujqësisë, etj.

Mjerisht në gjuhë t'onë nuk kemi të tilla kallzime në poezi a në poezi, të shkrueme me një gjuhë e stil për t'u marrë si model, me një formë gjuhe të kandshëme, të hieshme e të gjalë. Më bie ndër mend një copë këndimi në librin e këndimit për klasën e katërt të Filllores. "**ankimi i lepurit,**"; vjershat e Fishtës: "**Gjuha Shqype,**" "**Deka,**" "**I dhuemi,**"; ato të Asdrenit "**Puna,**" "**Punëtori i mirë,**" "**Misiri,**" i Çajupit ke "**Baba Tomorri,**" e ndonji tjetër. Mirë po këto janë copa për të mëdhëjt dhe jo për nxënësit e shkollave fillore.

Poetët t'onë kanë hartue e trajtue vjersha për të mëdhëjt me një stil e gjuhë, që kapërren fuqinë mendore të nxënësvet të Filllores e të Qytetses. Nuk kanë dalë edhe ndër ne poetë, që të kenë qenë në shues, të kenë jetue e shijue jetën e shkollës e të njohin shpirtin e fëmijës. Poetët t'onë, sado që kanë krijuë vjersha për Lukuri, si ato të Fishtës, të Prensushit, të Haxhiademit, të Koliqit, etj, nuk kanë zbritë e nuk janë ulë ke bankat e shkollës fillore, për të trajtuar su-

bjekte që të rrëmbëjnë e të tërhekin shpirtin e fëmijvet. Kjo mungesë rrjeth prej se, si thashë, ata nuk kanë qenë mësues të vegjëlish. Sa për prozatorë, shkrimet e të cilvet të mirren si model gjuhe të kulluet e të pagabueshme, nuk kemi jo për të vegjëlit vetëm, por as për të mëdhëjt.

Kemi nevojë të madhe për poetë e prozatorë, që të trajtojnë subjekte prej historisë së natyrës, prej historisë, prej gjeografisë, prej moralit; subjekte ngjarjesh, udhëtimesh, deskripcione fortesash, malesh, lumnash, fushash, qytetesh, katundesh, etj, shkrimet e tilla nuk do ta marrin shtazën a bimën, malin a fushën, etj, si një objekt të shkencës, të historisë së natyrës; të gjeografisë a të historisë, por do ta paraqesin, do ta kallojnë, këtë intuitivisht në rrethin e tij të natyrshëm, plot me gjallni e me jetë. Për këso shkrimesh, në poezi a në prozë, ka nevojë shkolla e jonë, që të mund të shtjerë në zemrat e fëmijvet, si landë mësimi, atë **jetë**, që nuk mund t'u paraqitet fëmijvet si **realitet**, si **nji-mendësi**.

A. Xhuvani

Nuk di asnjë kriter më të sigurtë, për vlerën pedagogjike të mësuesit, se sa mënyrën e të pyeturit, nuk njof asnjë të tillë që të zbulojë më mirë e më shpejt ç'grykim, metodë e dijë munt të ketë ai.

(A. Vessiot)

Mësuesi

Nga personaliteti i mësuesit mvaret, për pjesën më të madhe, përfundimi i edukatës; kjo e mbamja është veprimi i atij.

Ndër të gjitha rasët, mësuesi duhet të jetë njeri shembulli me kuptimin e vërtetë të fjalës; e njofim mirë fuqinë e frymzimit dhe të përgjasimit, por nuk do të mundemi me harrue edhe qëllimin e të krejtë edukatës: me mësue dhe me dhanë moral. Për të ju predikue të tjerve urtisinë dhe të dhanëit me shpirt, duhet me dhanë shembuj dhe me dijtë me pranue me gëzim një jetë pune të plot-fuqishëm nëpërmjet të fjalës dhe të veprimeve shembullore.

Mirë-rritja e fëmive është një punë serioze dhe me rrjedhime të mëdhaja shumë kurr të ju lëshohet duervet të pá-zoja, të pá-dëja ase të pá-ndergjegje. Në mësuesin do të përmbliidhen cilsina vullneti, cilsina intelektuale, fysike dhe morale, cilsina vullndeti, cilsina morale.

Mësuesi do të ketë vullndet: ai do të ketë taktin dhe kujdesin, por edhe i qindrueshëm dhe i drejtë.

Ai po do të ketë dashunin e nxënësave, dashunin e mjeshtërís së tij; virtyte morale kërkon detyra e mësuesit: besniku në detyrë, kujdes të madh në përgatitje dhe në të dhanun zhvillimi të njëj subjekti, i pá-lodhun edhe në qoftë se frytet mungojnë, qindresë të madhe edhe në qoftë se pagesa báhet e pá-kurrfarë mirnjoftjet; ai po do të ketë cilsinë e së të dhanëmes me shpirt, përvujtnin, një butsi atnore, një barsim hujesh; i pá-anëshëm ndër gjykime.

Ai do të api provën e duresës, prova bursije kundrejt fëmive. Ai s' do të ndeshkojë kurr me zemër të fryme nga idhnimi ase nga mënjia; me e gjykue punën pedagogjisht, mund të thohet se, mësuesi i cili kërkon ndihmën e ndeshkimevet, tradhtohet shumë. Që mësimi i tij vuen nga një gabim i randë pedagogjik, është puna se ai nuk e ká cilsinë e duhun të njëj mësuesi. " Fëmija

duhet të jetë plotsisht ndergjegjës i rolit që lot, që kështu të báhet i zoti me gjykue dhe me kritikue punët e veta, simbas përfundimevet që tregohen në veprimin e tij praktik. Po, vetëm me këtë mënyrë fitohet një gjykim i rregullshëm dhe i mirë, tue bá me gjetë gabimet e veta dhe tue i gjykue me vlefëtn e tyne të drejtë. ¹⁾

Mësuesi s' do të jetë i vrasht; autoriteti despotik, terhjek mungesë besimi dhe bindjeje. Fëmija i vumun nën një rregull të till, përçohet në një mënyrë të pá-dukshme kah rrëna dhe hypokrizija. Prandej ndër klasët t' ona, të shkojmë sá má shpejt që të jetë e mundun, nga zonat e ngrime kahë të ngrohtat dhe të vaptat. Fjalët e pá-pëlyqeshme kundrejtë nxënësit, të tallmet dhe të përqeshmet janë karakteri dallues i njëj edukate morale të përkundërt.

Në njeriun vrojtues të detyrës të drejtís dhe moralitetit, sikurr është mësuesi, ai do t' i njofin ligjísht gabimet e tij; në sá që fëmijit nuk do të mendojnë ndoshta dhe as nuk do t' u vejë ndër mënd atyne ndonji send për një punë të tillë.

Ai do t' u a naltësojë edukatën e ndjenjave, të vullndetit dhe t' u ndihmojë në trajtimin e karakterit të pá-tundun dhe të drejt.



Mësuesi do të ketë nderim ndaj fëmijt, ndaj prindt dhe autoritetet me dijen e tij të fitueme nga experianca e punve, një nderim të till me të dhanun shpirt, me mirsinë e tij dhe me entuziazmin e tij.

Mësuesi që nuk bán tjetër veç se ep dije, nuk është tjetër veç se një mjeshtër zanatli; kjo nuk mjafton; ai duhet t' edukojë që të jetë një artist në mjeshtërín e tij thotë W. Parker-i.

Nga mësuesi mvaret njoftja përsëri e njëj shkollë shtetnore dhe ardhmënjia e lummeshme e kombit Atëhere po, një frymë pushtuese ká për të hapë fletët e saja dhe me plot besim e dëshir ajo do të hypi ndër kulme të shkëlqyeshme të shkollës së jetës dhe të moralit.

Elbasan, Kalinduer 1937.

Sh. Arra

¹⁾ J. Dewey l' Ecole et l' enfant f. 141.

Vajzat në Normale dhe me këtë rasë Pak fjalë mbi koedukacionin.

Shkolla e jonë është "mikste"; nuk ka veçse pak vjet që ajo pranoi në gjirin e 'saj vajza. Numëri i këtyre çdo vit vjen duke u-shtuar. Mjerisht na mungojnë shifrat për të treguar se sa kanë qënë vajzat kohë mbas kohe. Vjetin shkollor 1934-35 bashkë me Drejtorinë e shkollës u-dogjën dhe regjistrat nga të cilat do të mundnim të nxirnim statistikat e çdo vjeti. Fakti është se shtesa e vajzave, që ndjekin mesimet në Normale, ka qënë e madhe për çdo viti mjafton të shënohet se në tre vjet' e sipër ato janë dyfishuar. Ndërsa në vitin shkollor 33-34 ndiqnin mësimet jo më tepër se 50 dhe më 34-35 arrinin numërin 65, sivjet janë përmbi 90 në klasat ndryshme. Kjo shtesë na kënaq sepse i jep një hov të ri përparimit të koedukacionit.

Me këtë rasë duam të bëjmë pakë fjalë mbi koedukacionin edhe rëndësin e 'tij. Do të tregojmë, shkurt, si ka filluar të përhapet që në kohërat më të para e gjer më sot; do të shohim se cilat janë arësytet, që kanë shtyrë Pedagogët e ndryshëm, që të pranojnë sistemin koedukatif si më të përshtatëshëm nga ai uniseksual.

Të bashkuarit e djemve dhe të vajzave në një arësim dhe edukatë të përbashkët ka gjetur pengesa të shumta. Po ato pengesa, që qindëra vjet përpara i dilnin si kundrështare koedukacionit, në vëndet më të përparuara të Dheut, mbasse i gjëjmë edhe sot në vëndin t'onë. Sikurse në shtetet e tjera, për të mirat që sillte koedukacioni, filloi të përparonte, ashtu edhe në vëndin t'onë është duke bërë hapa të mira drejt aritjes së idealit të 'tij: Edukata e njëllojtë dhe e përbashkët e djalit dhe vajzës shqiptare për mbarëvajtjen e shkollës dhe të shoqëris shqiptare

Pak Histori.

"Për të parën herë vajzat u-pranuan në shkollat e djemve në shekullin e XVII në Skoci dhe Amerikë. N'Europë, Comenius-i, në " Didattica Magna " (1630) kishte shpallur të drejtën e të gjithë djemve dhe vajzave për një arësim të plotë dhe të për-

bashkët Përkundrazi Fenelon-i (1690), duke ngulur këmbë mbi nevojat e ndryshme të të dy seksve, tha se i duhet çdo njërit prej 'tyre një edukatë e veçantë.

Pestalozzi qe ay, që i dha koedukacionit vëndin e nderit. Koncepti i tij: Shkolla duhet të jetë fytyra e familjes dhe, për këtë arësyje, duhet të grumbullojë së bashku djem e vajza, është një argument edhe sot për ata që mbrojnë koedukacionin. Ai e zbatoi në Stanz dhe pjesërisht në Berthud; në Yverdon na shohim vajza e djem, të të dy shkollave të ndryshme, të vëllezërohen mbrëmanet gjatë dëfrimeve të 'tyre. Influenca e 'tij qe e madhe sidomos në vëndet Anglo-Saksone.

Richter përkrahu të mirat morale të koedukacionit duke thënë : Për të suguruar zakonet unë këshilloj koedukacionin e seksve. Dy djem mjaftojnë për të ruajtur 12 vajza; dy vajza për 12 djem. Por unë nuk siguroj asgjë në shkollat ku vajzat rriten veçanërisht dhe, aqë më pakë, në shkollat ku s'ka veçse djem ..¹⁾

Në shënimet e lartë përmëndura shihet qartas se cilat janë qëllimet që frymëzuan Pedagogë të ndritur si Comenius-i Pestalozzi. Richter, etj. për një edukatë të përbashkët të të dy seksve (djem e vajza)

¹⁾ " Pour l' Ere Nouvelle, " Viti I, Nr. 2

Rëndësi të madhe i dhanë koedukacionit qëllimet morale të këtyre Pedagogëve.

Po të bëjmë një vëshjim të gjerë të Historisë së koedukacionit do të shohim edhe faktorë të tjerë që kanë marrë pjesë në përparimin ose ndalimin e 'tij. Një nga këta faktorë, në të gjitha vëndet dhe në të gjitha kohërat ka qënë **emancipimi i gruas**. Mund të themi se koedukacioni është përhapur krahas me fitimin e të drejtave të gruas, prandaj, më tepër se kushdo tjetër, femra duhet ta shikojë me sy të mirë. Ajo tek koedukacioni duhet të shikojë një nga provat e nivelimit të sajë me mashkullin. Kur ushqehet mëndërisht dhe shpirtërisht në një bango, krahas me mashkullin, a nuk është në një shkallë me 'të?

Duket qartas nevoja e përhapjes së koedukacionit sidomos në vëndin t'onë ku femra, për shkak të mëndësis s'onë praparnike, është krijesa më fat-keqe

Thamë në fillim se koedukacioni sjell shumë dobi me rëndësi. Cilat janë këto dobi?

1) **Lartësimi ose fisnikërimi i Instinktit.**

"Ky instinkt, me origjinë shtazore, ka mundësinë të lartësohet në ndjenjat më fisnike edhe më delikate," thotë Adolph. Fërriëre në studimin e 'tij "Coeducation et Mariage". Përsa i përket lartësimit të instinktit, Pedagogu Hil Dcman shkruante disa vjet më parë: Koedukacioni më duket regjimi edukatif që garanton shvillimin normal dhe një evolucion më shpirtëror f'instinktit seksual.

Dr. Saffray.

2) **Veprimi i njerit tip mbi tjetrin**

E dijme se vajza është një "tip," me cilsiira më vehte dhe djali një "tip," tjetër me cilsiira më vehte. Këto vetija, kur edukimi bëhet veçanërisht, shvillohen së tepri. Kur edukata është e përbashkët, disa cilsiira të mira të mashkullit i merr femra edhe përkundrazi: djalit i stërhollohen më tepër ndjenjat edhe bëhet më i butë; vajza bëhet më e thellë në të menduar dhe fiton kuxim. Këto ndryshime të gjithë i kemi vënë re në djem që janë shoqëruar sado pak me femra edhe në vajza që kanë marrë edukatë të përbashkët me djemt.

3) **Të Njohurit e njeri-tjetrit.**

Kjo është pika më me rëndësi; dobia e saj është e madhe si nga pikpamja familjare ashtu edhe nga ajo shoqërore. A mund të kemi një familje të lumtur ndër bashkëshortë që janë martuar pa u-njohur? Dashuria e sinqertë e çiftit është kondita e domosdoshme e mbarëvajtjes familjare.

Po shoqëria e një kombi përgjithsisht a do të ketë dobi kur arësimitari dhe arësimitarja, mashkulli edhe femra nuk njohin njeri tjetrin? Kur themi njohje kuptojmë një njohje shpirtërore të qartë, të thellë, ndriçonjëse midis djalit dhe vajzës. Të mos ketë mashkulli një "illusion," mbi cilsiit e femrës por një idë të saktë, të plotë dhe të vërtetë.

I japim funt duke thënë: në vëndin t'onë koedukacioni punon për emancipimin e gruas dhe përpjekja për emancipimin e gruas na shpie drejt koedukacionit.

Harilla Kuçuli

Mësimet e jetës.

Mësimet e jetës janë të vjetra sa edhe edukacioni, mbassi në të gjitha kohët e në të gjitha vëndet, pedagogët e mëdhej praktikuen mësimin me anën e të pamit dhe njëjtën nevojat me vù në fitim intuitën, nën

tre format e saj: ndjejore, mendore e morale. Por edukatorët modernë kanë krijuem metoda për këtë mësim dhe kanë përgatitë me mësimet e me shkrimet të përhapunit e këtyne sistemave edukative.

Ata që ngrihen makar dy gjishtë mbi nivelin ordinar duhet të kuptojnë përgjegjësin' e tyre.

LUMO SKËNDO

Nicole shkruente më 1671 në lajmërimin e tij të veçantë përsa i përket studimevet: "Mund të thohet përgjithnësisht se njohunitë e fëmijvet janë gjithmonë shumë të mvaruna prej shqisavet; duhet pra me dhanë njohuni sã mã tepër të jetë e mundun nëpër mjet të ktyneve dhe jo vetëm nëpërmjet të të ndëgjuemit, por edhe të të pamit, mbassi nuk ka shqisë tjetër që të lãjë mã mirë se kjo, një impresion të gjallë në shpirt e të formojë ide mã të kthjellta e mã të dallueshme..

Comenius i i proklamuem prej Gjermanisë babaj i metodës intuitive, nuk ka çfaqë veçse mã vonë këto idë në librin "Orbis Piktii", tue thanë: "Themeli i çdo ditunije qëndron në të mirë-paraqitun'it e sendevet në shqisat t'ona, në mënyrë që të munden të përmbliiden me lehtësi. Kush don me përfituem prej kësaj vepre, duhet të veprojë në mënyrë që fëmijët mos shofin asnjë send që ata nuk dijnë me e emnuem e po kështu asgjã mos emnohet, pa dijtun me e treguem..

Sistemat që edukatorët aplikojnë tani, ekzistojshin prej shumë shekujsh në pedagogjinë franceze; gjinden ne Fënelon i sikurse edhe ne Montaigne, ne Rousseau e Rollin i. Ja për shembull ajo që Rollin-i thotë në kapitullin e 'tij mbi fizikën e djemvet:

"Asgjã nuk është e përgjithme ndër ne sa përdorimi i bukës e i të lintavet e vazhdimisht asgjã nuk është mã rrallë se me gjetë fëmijë, të cilët të dijnë si përgatiten njana e tjetra; në sa mënyra e nëpër sa duer kalon kokra e grunit e konopë deri sa të të bëhen bukë e të linta përse mos me i mësuem fëmijët në këto vepra të çuditëshme të natyrës e të artit, të cilat ata i përdorin çdo ditë pa u menduem ?

Gjejmë akoma në një plan të ri t'edukatës, të botuem më 1775 prej Carpentier profesor Universiteti, kët programë të shkurtër të "Mësimve të jetës,: Unë due që djali i em të dijë se si bëhen çerapet, këpucët, stofat për rroba etj.

Sa të jetë e mundun të paraqisim sende, të cilavet sende duem me i thanë emnat e me spjeguem veçantitë; tue e filluem këtë ushtrim po n'atë kohë që fillon edhe kursi i edukatës, tue përfituem në mësimet t'ona deri sa të vazhdojë kursi, Në lojë ose në shtëpi, në katunde ose në qytet, kudo gjinden sendet dhe këto sende kanë emna, përdorime, veçanti, d. m. th. se ky ushtrim mund të bëhet kudo..

Me këtë metodë pedagogjike Carpentier propozonte " të bëjë prej njerëzvet, qytetarë të lumtun..

Asht pra, e sigurt që mendtarët t'onë, filosofët, edukatorët e mirë kanë pasë prej shumë kohësh përkujdesjen me e bënë mësimin nëpërmjet sendesh, në vend të atij qi merrësh vetëm me fjalë.

Për të parën herë Gjermanët kanë dijtun me përfituem prej këtyne ideve të reformës dhe kanë themeluar mësimin e realitetit, d. m. th. të sendevet reale. Ky aplikim i doli atyneve shumë mirë; por ne tue i imituem, do të vëhemi në një rrugë të rreme, mbassi nuk e kuptojmë, sikurse e kuptojnë ata "mësimin e sendeve..

Ata bëjnë, pothue se katalog, një inventar pa shije e frut, më të cilin çështjet i drejtohen mã tepër kujtesës se sa rifleksionit e gjykimit'. Nxanësi mësohet me u përgjegjun me një fjalë të vetme, në vend që të ushtrohet me folë.

Kështu filloi Pestalozzi e qe, pa dyshim, mbas një kësi mësimi pa gjallni e shije, që një mik e gjeti të dekorajuem në fund të kopështit 'tij, kokën të mbështetun ndërmjet të duervet, tue qamë si një fëmi e tue përsëritun me ambëlsi: "Nuk është ky pra! Unë nuk e kam gjetun ...

Fundi i mësim-sendevet është me mësuem me vëretë, sendet me i emnuem, me i krahasuem, me kuptuem ndryshmënisht përdorimet e tyne, originën, historinë e tyne, transformimet etj.

Tue u mbështetun në kuriozitetin natyral të fëmijës, mësuesi mundet lehtësisht me e ushqem ate dhe mjeti mã i mirë është ta bëjë të marrë pjesë aktive në më-

sim. Mjafton për këtë me detyruem fëminë t'i shërbejë kryesisht shqisavet 't'ij (me anën e mësimit) mandej arsyet për me kaluëm prej çdo pike të njoftun në atë të panjoftunën. Duhet ta bëjmë që ai të zbulojë, në mënyrë që mos të mbetet veçse me i drejtues e me i plotsuem idetë e 't'ij.

Mësimi i sendevt duhet të jetë një ushtrim vrejtimi për shqisat e për shpirtin e për këtë është e doemosdoshme me i paraqitë fëmijvet mostrat e sendevet, modelet, vizatimet. Pa mbështetjen e koleksionevet, mësimet e sendevet humbin karakterin dhe

dobinë e tyre, tue u-bastardhuem krejtësisht në një mësim fjalësh. Ja përse programat zyrtare detyrojnë mësimin e vizatimit e modelet që fëmijët mund t'i përdorin si provim të shqisavet, sikurse e kupton Rousseau-i, kur thotë: "Me ushtruem shqisat e veçanta, nuk don me thanë vetëm me i përdorë ato, por me i mësuem të gjykojnë mirë për vehten e tyre e në çdo mënyrë me ndi mirë, mbasi ne nuk dijmë as të prekim, as të shofim, as të kuptojmë, veçse si në është mësuem."

G. Santo '33.

Çështje të parrahura.

Në numërin tjetër botuam një artikull të shkurtër me titull: **Nji pyetje** N'atë një bashkëpunor i ynë, duke treguar hartimin e çuditshëm, q'i pati dorëzuar një nxënës i klasës së Vtë, pyeste arësimitarët mbi shkakqet e një hartimi t'atillë. Përveç kësaj kërkonte të dijë mënyrën me anën e së cilës një mësionjës i mirë do ta binte në regull atë nxënës dhe atë klasë.

Shpresojmë se shumë nga arësimitarët nuk do të përtojnë të shkruajnë mendimin e tyre reth një pyetjeje që bëhet me qëllim ndriçimi. E përkohëshmjia e jonë do të botojë përgjigjet më interesante, duke i shoqëruar me shënimet e duhura. Më në fund do të kërkojmë dhe mënyrën e atij q'e hartoi këtë "pyetje".! Eshtë e natyrshme që edhe ay i cili u-ndoth përpara një skene t'atillë të ketë menduar mbi këtë çështje që aq shumë i bëri përshtypje.

Na kemi dashur dhe duam që në rivistën t'onë të botohen thema që shkaktojnë bisedime. Themmat që shkaktojnë bisedime kanë shumë rëndësi, për dy arsye: Arësyeja e parë është: zgjuajnë interesin lëçitësve arësimitarë duke shkaktuar një lëvizje mendore midis tyre. **Pikënisja e çdo punimi serioz është të zgjuarit e interesit që, një kohësisht, ka kuptimin e shtytjes për punë.** Përveç kësaj themat

e lartëpërmendura sjellin përfundime praktike të dobishme për arësimitarin.

Me rasën e këtij shënimi të vogël duam të shkojmë dhe pak më tutje: do te pyesim: a mund të gjëjmë çështje dhe problema për të rrahur në një rivistë? Me fjalë të tjera, a kemi ç'të shkruajmë? Kujtojmë se asnjë nuk do t'i përgjigjesh kësaj pyetje me një "Jo", të prerë. Or e çast arësimitari gjindet përpara veshitërësive që po të mendojë mirë mbi 'to, do t'i gjëjë problema për t'u rrahur dhe çështje për t'u shoshitur. Këto janë problema me vlerë të përgjithëshme; duke i përjashtuar këto arësimitari t'onë i paraqiten kohë mbas kohe çështje pedagogjike q'i përkasin detyrës së tij si "mësonjës shqiptar."

Ja disa pyetje që ne kandidatet mësonjes duam të dijmë! Ti mësonjës shqiptar si bën për të zëvendësuar mjetet e mësimt, si t'edukatës mendore ashtu dhe t'asaj fizike, në vetminë e katundit ku gjëndesh? Për të disiplinuar nxënësit a të mjafton sistemi edukatif i huaj që është i përshtatur djaloshit Gjerman, frances, amerikan, etj. Përdor një mjet më tepër a më pak për t'i shpurë nxënësit atje që dëshiron vetë?

Në mos qofshim të zotë, për të shtjelluar një subjekt pedagogjik në mënyrë

shkencore, të paktën, jemi në gjëndje të japim një mendim mbi problema, që janë krejt praktike. Janë disa çështje zgjidhja e të cilave mvaret nga metoda e veçantë e çdo mësonjës. Shumë mësonjës gjënden përpara veshitirësive të njëllojshme në punën e tyre. Këto veshitirësi nga disa përballohen më lehtë se nga disa të tjerë. Që të përballosh një nevojë të tillë dhe që të kryeq punën siç duhet kur të paraqiten pengesa të forta si ato që shpesh herë gjen mësonjësi shqiptar, nuk mjafton të kesh dalë nga shkolla Normale; nevojitet një

origjinalitet të të menduari për të gjetur mënyra të veçanta a "metoda rasti", me të cilat do t'i kalosh ato pengesa. E pra këtë cilesi nuk e kanë të gjithë. Ata që janë në gjëndje dhe janë të pajisur me këtë zotësi e kanë për detyrë të ndriçojnë të tjerët.

Përveç këtyre që treguam, sa e sa problema pedagogjike janë për t'u zgjidhur, sa e sa çështje janë për t'u rrahur, sa e sa thema janë për t'u zhvilluar në dobi t'Aresimit t'onë fillor. Të gjitha këto vetëm mësonjësit e ndriçur i dijnë.

"Normalisti,"

Të bërit gati të klasës është të domosdoshëm.

Kjo gjë është një çështje vitale që kryeson mësimin dhe shpjegon përfundimin.

Të bërit gati të klasës është të domosdoshëm. Si mbështetje të kësaj munt të paraqisim arësytet që vijnë :

a) Programet e sotme përfshijnë shumë lëndë dhe kërkojnë prej mësuesit një dije të gjerë dhe të gjithanëshme. Nga ana tjetër kanë ndryshuar me programin dhe metodat. Përdorimi i "procedimeve mekanike, është përzënë nga shkolla; nuk është më kujtesa në punë.

Studimi i vetëm e i thjeshtë i librit nuk pranohet më, dhe u kuptua që të vijuarit të ftohtë të mësimevet nuk sjell veç se mërzi dhe plogti mendore. — Tani duhet t'i drejtohem papushim mëndjes (inteligjencës) dhe zëmërs; t'a shtyjmë femijën të mendohet e ta bëjmë të flasë; t'i japim mbi çdo çështje fillzime të kthjella e të plota, ta bëjmë mësimin, sa të jetë e mundur, të gjallë e tërheqës.

Barra e mësuesit është fisnikëruar por

është berë dhe më e rëndë.

Për këndimin na kuptojmë këndimin e rrjedhshëm; nuk mjafton më " të nxënë për të kënduar ", femijit; duhet dhe t'u kallzojmë kuptimin e përgjithshëm të pjesës. Një faqe duhet të këndohet mirë, duhet, përveç kësaj, dhe të kuptohet fare mirë.

— Diktimi, aq i lehtë më përpara, s'ka për qëllim të vetëm të mësojë orthografian, ai duhet që të ndërhyjë njkohësisht dhe në kulturën e përgjithshme të mëndjes. Teksti i një diktimi duhet të fillzohet si teksti i këndimit.

Hartimi është bërë një ushtrim i nderliqëm dhe delikat. Nuk është më ai hartim i parë, në të cilin kopjohesh ç' mbahësh mënd nga copa e kënduar. Duhet që çdo subjekt hartimi të studjohet përpara se ta trajtojmë me shkrim, dhe që në një bisedë të gjallë, mësuesi t'i bëjë nxënësit të gjejnë idet e qënsishme.

Por nuk fillzohet një copë këndimi.

Të mos bërit gati të një mësuesi tregon që ja se është përtac, ja se i pëlqen mëndja e 'tij.

një diktim, një subjekt hartimi pa ditur më përpara ç' do të thuash: **shtrëngohesh pra të bësh gati klasën.**

E për historin e gjeografin cilët janë ata mesues tani që dëshirojnë të kufizohen me të hapurit e librit, ta thonë mësimin pa dhënë asnjë fillzim dhe pastaj t'ua japin nxënësve për të nxënë?

Tani asnjë mësues nuk vepron më kështu. Çdo mësim historije e gjeografije paraqitet me metodë e kthjelltësi prej mësuesit, që, përpara se ta japë, e ka bërë gati.

Mësim i shkencave, si çdo mësim tjetër, nuk munt të shtjellohet pa gatitje përpara nxënësve. Ky mësim kërkon shumë rregull dhe njohni të kthjellta e të preme.

Ka ndonjë mësues që të lëshohet për të bërë një mësim shkencash — pa e bërë gati më përpara? Do t' ishte aq i lehtë sa t'ja fillojë një prove pa ditur në se do t' a shpjerë në përfundime të mira?

Përpara punët e klasës ishin po të thuash të lehta; mirresh mësuesi me 'to, po nuk lodhesh. Sot nuk është më ashtu. Klasa kërkon nga ai një ndërhyrje direkte dhe të paprerë, dhe i lë vetëm pak pushim. Me të vërtetë mësuesi është i lirë që prej orës 4 të mbrëmjes dhe deri më tetë e gjysëm të mëngjezit; po, kur bje ora katër ai s' është çkarkuar edhe: duhet të mendojë për mësimet e nesërme që ka për të dhënë, detyrat që ka për të trajtuar e për të ndrequr. Në mbrëmje, mbas shpërndarjes së nxënësve, dhe në mëngjes, përpara ardhjes së tyre, do t' i vihet punës së gatitjes, së cilës s' ka njeri të mos ia njohë nevojën.

Mësimi që fëmijt vinë e kërkojnë në shkollë, është caktuar që t' **ushqejë** shpirtin e tyre, pra moralisht si dhe fizikisht një ushqim nuk është me të vërtetë i dobishëm veç se kur zgjidhet dhe **bëhet gati**. Kjo zgjedhje dhe kjo **gatitje** bëhet përpara se ta hamë d. m. th. (për mësimin) përpara se të hyjmë në klasë.

b) Mësues jo aq të zellshëm do të thonë ndoshta: "Pa dyshim gatitja e klasës është më e rëndë se përpara, por titujt,

(maturant, stazhist) që kemi ne, janë më të lartë se të "çamtallive". Me mësimet që kemi mësuar në Normale dhe që kemi paraqitur në provime administrata na ka njohur të zott për të mësuar në një shkollë fillore; nuk mjafton kjo? ..

Është tepër lehtë t' i përgjigjemi këtij kundërshtim. Një mësues, edhe dhe Normale superiore të ketë mbaruar, në qoftë se pushon së studjuari, nuk do të vonojë të humbasë një pjesë të madhe të njohive që ishte shtrënguar të nxinte për të marrë "diplomën". Nji ditë, duke mësuar në klasë një mësim historije, do të shohë, p. sh. që i shpëtojnë emra dhe hollësira, e që nuk i kap dot mirë marrëdhënëjet midis ndodhirave. Janë bërë zbrastira në kujtesën e 'tij; janë fshirë disa mbresa, gjë që është punë e kohës.

Ka shumë mësuesë, të cilët të mbështetur në njohit e vjetra kujtojnë me gjithë ment që janë të zott të bëjnë një mësim.

Ç' ngjan atëhere? Mësuesit flasin pa gjallëri, pse je i gjallë vetëm atëhere kur je plot me lëndë; ata ngurojnë, hidhen andej këndej në gjëra të pasigurta. Nxënësit e kuptojnë. Inspektori më mirë (në qoftë se është atje) dhe më në fund këta mësues nuk janë të kënaqur nga vetja. Ata ndjejnë mirë që një mësim i tillë është i keq ose të shumtën mezatar.

Shumë herë, kur mësuesi nuk është bërë gati, në vënt që të heshtë e të dëshmojë shterpësin e tij, zë e flet pa ditur çë. Paraqitja e mësimi në këtë rasë është vetëm verbalizëm. E me të vërtetë mësuesit e pajosur me një farë lehtësi të foluri, duke kuptuar që njohit e tyre s' mjaftojnë, përpiqen të mbushin zbrastirat: Hidhen atëhere n' oratorira, ngulin këmbë pa arësye në disa hollësira pa rëndësi, kurse pjesët kryesore mbesin t' errëta. Kta vetëm flasin një kohë të gjatë, pse janë të pazott të shtjellojnë subjektin që trajtojnë dhe të nxjerrin pastaj përfundimet. Një mësim i bërë kështu s' është i plotë dhe i mungon

ekuilibri, është po thua pa fitim për nxënësit.

Për këto arësye pra duhet të vijojmë të punojmë që të mos lëmë.

Për këto edhe duhet t'u shtojmë njohive të përgjithshme, që kemi fituar në shkollë, dhe njohit e veçanta dhe të përnjëherëshme, që kërkojnë çdo mësim që do të bëhet.

Pa dyshim kjo gatitje e fundit kërkon kohë dhe përpjekje, po a nuk shpërblehet mësuesi kur e zotëron mësimin dhe e bën lirisht e me lehtësi atë ?

c) Në qoftë se mësuesi e mbaron detyrën me gëzim, në qoftë se mësimi i tij është i pasur me lëndë dhe interesant, fëmijë do ta duan shkollën, dhe vijim i tyre në shkollë do të jetë më i rregullt. Përse në disa shkolla venë nxënësit më shumë e përse në disa të tjera, fqinj me të parat, venë mjaft më pakë ? Nji ka thënë : " Çdo mësuesi i venë aq nxënës sa meriton ". A nuk mbërthen kjo fjalë një pjesë të madhe të së vërtetës ?

d) Të bërit gati të klasës përkrah gjithashtu dhe disiplinën. Kur çdo gjë është paraparë, e zgjedhur, e bërë gati përpara, s'ka në shkollë as turbullime as humbje kohe dhe nxënësit nuk shtyhen kurrë të dëfrehen dhe të bëhen fjalamanë. Përkundrazi, kur mësuesi kërkon me nxitim një problemë ose një diktim ose kur shkruan në dërrasë të zezë tekstet e detyrave që duhet t'i kish shkruarë përpara, nxënësit hallakaten.

E përktheu : **Nxënësi**

Provë mësimi

Dhanun në klasën e III të
t' ushtrimore

Elbasan 30-XII-36

Lënda : Arithmetikë

Thema : Zbritje e numrave me hua.

Zhvillim

Me kenë se mësimi i arithmetikës është një lëndë krejt e thatë në vetvete, mësuesi duhet të mundohet qi ta bájë në një më-

nydrë sa ma konkrete, qi kështu nxansit t'a kuptojnë dhe ta përvehtësojnë sa më lehtë. Prandej për me bā qi të kuptohet mekanizmi i marrjes hua në veprimin e zbritjes, është nevoja qi të bāhet ma parë nji zbritje konkrete me objekta ose me vizatim, mbasandej nji zbritje me shkrim për me tregue paralelizmin (mëndyrën e të shkruemit paralel me vizatim ose me objekta) ndërmjet të veprimit të shkruem dhe të zbritjes me objekta. Shembujt qi do të bahen kanë për të pasë :

1) Zbritje konkrete d. m. th. nji të paksuem të koleksionevet, në të cillët objektat janë të grupuem nder 10 sha 100-sha etj.

2) Të paraqitunit e këtij grumbullimit nëpër injet të nji vizatimi shematik.

3) Zbritja e numrave përgjegjës të shkruem me shifra.

1) Siç dihet, qi në çdo mësim t'arithmetikës mësuesi duhet të bājë disa ushtrimet përmendësh, qi kështu të stërviten nxansit dhe të hyjnë ma lehtë në paraqitje.

2) Objektet e nevojshme : objekte për zbritje; objekte të ndame dhe të grupueme nder 10, she.

Hyrja. — Puna. Disa shembuj : mës. Sa bājnë 13-5; 12-4; 15-9 etj.

Paraqitja. — Mës. Agimi kishte në dorë 53 lapca, 26 prej këtyne donte me i a dhënë nji shokut të vet; sa lapca i ngelën atëherë Agimi në dorë ? Për këtë veprim mësuesi qet nji nxënës, të cillit i jep në dorë 53 lapca, por të ndamë ndër 5 paketa kah 10 dhe 3 lapca të shkoquna. Në këtë kohë mësuesi do të pyesi se çka do të bājë ma parë dhe si do t'ia apin shokut 26 lapcat. Nxansit do të përgjigjen si mbas mendimit të 'tyne. Mbas kësajë mësuesi do t'i kërkojë nxansit qi është përpara, qi t'i api shokut të vet ose mësuesit 6 lapca. Nxansi në këtë kohë i ndihmuem prej mësuesit do të marri nji paketë 10-she dhe t'a zbërthejnë në njisha, qi t'ia shtojnë 3 lapcave tjera dhe kështu bāhen 13 lapca. Prej këtyne do të hjeti 6 lapca, të cillat do t'ia api mësuesit ose shokut të vet dhe tepriçën e mban vetë; mbas kësajë ngel

për t' i dhanë shokut edhe 20 lapca të tjera. Këtu mësuesi pyetë nxansit se sa paketa ka në dorë shoku, ata natyrisht tue i pa me sy thonë se ai ka në dorë katër paketa; në këtë kohë nxansi i ep shokut ose mësuesit me të cillin vepron edhe 20 lapca dhe mandej mësuesi pyet nxansit prap sa lapca i kanë mbet në dorë shokut të tyne ose sa paketa 10-shash e sa lapca të shkoquna. Nxansit natyrisht tuj i pa me syë do të thonë se atij i kanë mbetë edhe 27 lapca ose 2 paketa 10 shash e shtat lapca Për veç këtij ushtrimi bëhen edhe disa ushtrime tjera me lapca tuj ngritë nga një nxanës përpara shokve.

Për me bā disa zbritje me shkrim bëhet prap me anën e vizatimit në drrasë të zezë, tuj shembullue 10 shet me anën e një katër kandshi □ dhe njëshat me anën e një vijës vertikale I. Paralel me këto do të shkruhen edhe shifrat (numrat) qi do të zbriten, si ushtrimi i përparshtëm 53 lapca qi kishte Agimi i dha shokut të vet 26 lapca; sa lapca i tepruen? Mësuesi do të rravizojë 5 katër kandshat kundrejtë dhe 3 viza vertikale, nën këto 2 katër kandsha dhe 6 viza vertikale. Si të jetë bā veprimi në mënyrë shematike, mësuesi pyet nxansit se si e bāmë ne më parë zbritjen me lapca. Në qoftë se nxansi nuk mund ta bājë, atëherë i ndihmuem prej mësuesit hjek një nga katër kandshat dhe i a shton vizave, por tue e zhgatrrue atë ndër 10 copa qi bëhen 13 viza. Këtu mandej mësuesi i ndifë atij qi t' i zbresi njëshat nga njëshat (vizat) dhe mandej 10 shet (katër kandshet). Paralel me ket duhet të bājë edhe veprimin me shifra (numra).

Me këto mënydra nxansit i rranjoset thellsisht rregulla e të zbrimit tuj marrë hua një 10-she nga 10-shet tjerë.

Ushtrimi: Si të jetë kuptue mirë veprimi bëhen disa ushtrime në drrasë të zezë, të cillat i përpunojnë nxansit bashkë me mësuesin

Disa ushtrime : Sa bājnë 83-27; 94-69; 71-13 etj.

Tabela e mësimit

□ □ □ □ □ □	□ □ □ □ □ □	5 ¹ -13
-	□ □ □ □ □ □	-2 6
□ □ □ □ □ □	□ □ □ □ □ □	2 7

Hilmi Duli :37.

Provë mësini

Dhanë në kl. e IV t' ushtrimes

Landa : Punë dore

Tema : Nji bisk ullini

Mjete : Nji bisk ullini me gjethe dhe me kokrra

1) Përshkrimi i biskut. 2) Përshkrimi i pjesavet veç e veç (shufra gjethta e kokra) 3) Dimensionet e çdo pjese. 4) Ngjyrat.

Hyrja.— Një nga qëllimet e hyrjes është që mësini i ri të mos t' i duket fëmijës i ri e i panjoftun; prandaj mbassi orën e parë është folun mbi " ullinin " mësuesi si hyrie të kësaj ore bān një përsëritje të mësimit parë në pika të përgjithshme tue ushtrimun mā tepër në përshkrimin e bimës s'ullinit (rranja, trupi, degat) e për me dalun në qëllimin e mësimit pyet: ku i nxjerr lulet e kokrat ullini? (Nx. . . .). Mbassi të dali përgjegja se ullini kokrat i nxjerr nëpër bisqet, ahere mësuesi u qet nxanësve të parasysh nji bisk ullini me kokra e me

Pema më e mirë e mësimit nuk është aq sasija e dijës së fituar se sa aftësija për ta fituar atë pastaj, d. m. th. shija e studimit, metoda e punës, zotësija e të kuptuarit.

gjetne dhe ua lë nuanësuet për një kohë përpara, me qëllim që t'u rranjoset mir në mëndje fytyra që ka për t'u-punue.

1) **Përshkrimi i biskut.**— Mësuesi siç e ka në dorë biskun pyet nuanësit t'i kallzojnë pjesët e biskut (shufra, gjethet e kokrrat) b) mënyrën e të vumunit të gjethevet (të ngjytuna dy nga dy tue shkue nga maja e biskut tue u voglue në majët merr fund me një gjethe fare të vogël) c) mënyrën e të vumit të kokravet (të ngjytuna në rränzën e gjethevet nga njëherë dy ose tri kokrra dhe më të shumtën e herës një kokërr).

2) **Përshkrimi i pjesavet.**— Shufra në fund është pak e trashë dhe tue shkue nga maja më e hollë në ngjyrë hini. b) Gjethja ka formën vezake me një majë të mprehtë dhe me një bisht mjaft të vogël, i cili ngjii gjethen me shufrën. Kjo ka ngjyrë të gjelbër. c) Kokrra është e rrumbullakët dhe në vendin ku hyn bishti është pak si gropë; kur është e pa pjekme është jeshile dhe kur piqet nxihet. Gjithë ky veprin bëhet prej nuanësuet në bashkupim me mësuesin. Mbassi të marrë fund dhe përshkrimi i pjesave, ahere mësuesi u thot nuan: këtë biskullini, tue tregue biskun, do ta bajmë plotisht me këto ngjyra. Çkemi me ba pra sot? Nx. Sot do të bajmë punë dore. Në këtë kohë mësuesi përndan radhont e letravet me ngjyra bashkë me gërshanat e me fletoret e vizatimit, të cilët ruhen me kujdes nga mësuesi i klasës. Mbassi mbarohet këjo punë mësuesi bën një përshkrim të dytë sikurse herën e parë, por këtë herë epen dhe dimensionet.

3) **Dimensionet.** — a) Shufra ka ngjyrë hini, në fund më e trashë dhe në majë më e hollë. M. për me e bā biskun punë dore ç'far ngjyre do të presim? Nx. kërkohjë ngjyra në radhua. Mës. për me i provue nx. i nxjerrë një ngjyrë tjetër; por nx. i njoftin. Si të jet caktue ngjyra mës. në bashkupim me nx. cakton dimensionin p. sh. një gisht e gjymës të gjatë; gjanësia sa thoni i vogël. Mbassi të jetë pre letra mës. u-thotë tue tregue letrën e preme:

Kështu pritet bisku një gisht e gjymës i gjatë dhe sa thoni i vogël i gjånë, por tue shkue nga maja tue u-hollue. Mbassi mbarojnë të premit e biskut, shikon mësuesi me kujdes gjithë punën e nuanësuet. b) Gjethja më parë, caktohet ngjyra (e gjelbër) dhe veprohet si në zgjedhjen e parë, pastaj përshkruhet dhe një herë forma (vezake me majë dhe më bisht të shkurtën e të ngjytun me gjethen). Mbassi gjethet e ullinit dy nga dy janë të njinjshme mësuesi ep urdhën prej ngjyrës së zgjedhun të priten dy copa letra nga një gisht e gjymës të gjatë dhe një çerek gishti të gjånë; njikohsisht pret dhe mësuesi bashkë me nx. Mbassi t'i kenë premë të gjithë, mësuesi bën kontrollimin si herën e parë. Si t'a mbarojnë të gjithë mësuesi urdhnon palosjen e letravet të dyja bashkë dhe kallzon me një shkicë në dërrasë mënyrën e të pre-munit. Të kallzuemit e mënyrës së të pre-munit ka randësi të posaçme se shpesh herë qëllon që kur duem me pre ndonji rreth ose ndonji gjethe me të palosme s'del qëllimi (rrethi ose gjethja), por dalin dy gjymsa rrethi ose gjethje; prandaj mësuesi në këtë rastë letrën e palosme (anën e mbyllme) e kthen të gjithë në një anë të caktueme (nga ti vijë mirë nx) Për me e pasë dhe mësuesi anën e mbyllme nga e kanë nxënësit duhet të presi me dorën e majt, por në klasat e nalta (IV, V) që e dijnë anën e djatht e të majt mësuesi mund të presi lirisht. Mbassi të jetë caktue ana e të kthymit të letrës mës. e vizaton në drasë dhe një herë mënyrën e të premit dhe së bashku fillon të premit. Kështu veprohet dhe për gjethet e tjera, por gjithnji dy nga dy tue u voglue dhe në fund bën vetëm një të vogël fare. Si të jenë mbarue gjithë gjethet fillohet me u ngjii. Mënyra e të ngjytunit kallzohet prej mësuesit me një shkicë të bāme prej tij në drasën e zezë. c) kokrrat; dhe për kta caktohet më së pari ngjyra e dimensionit dhe veprohet si në gjethet, tue punue dhe mësuesi bashkë me nuanësit. Kokrrat e mbarueme ngjiten në biskun e bamun në mënyrën e tregueme

në dërasën e zezë. Tashti puna e dorës merr fund.

4) Korigjimi. — Në korigjimin ve-prohet kështu: merren më të mirat dhe lihen t'i krahasojnë fëmijt: por gjithnji tue qenë gjithmon observator i mirë vetë mësuesi e me i shikue me kujdes kritikata e nxënësve, të cilët ngà kurjoziteti ose nga mënjia njani me tjetrin bajnë shpesh kritika të kota. Kështu vazhdon puna ke të dobëtit. Ky lloj korigjimi ka mjaft vlef të se nxënësit kur i shofin dhe i tregojnë të metat e shokvet mësojnë dhe vetë kur të bjeri radha me punë; ka me i përmirësue me të vërtetë ato gabime që ai vet ka gjetë në punën e shokut: p. sh. shtremëti, më gjat se gjatë, po rrexohet etj. Pastaj kur të shofi punën e bukër të shokvet vet vetiu nxënësit ka me i u shtue dëshira me punue dhe si vet mir e bukur. Nji korigjim i bamë në shtëpi nuk e ka kurr vlef të e korigjimit të shkollës, kur nxënësit vetveprojnë si në punën e vetë ashtu dhe n'atë të shokvet.

Shënim

Në mësimin e punë dorës ose të vizatimit mësuesi duhet të caktojë ekzakit ngjyrat e dimensionet që ka me përdorë.

Provë mësimi

Dhanun në klasën e V
t'Ushtrimores

7-XII-936

Lânda: M. Morali

Thema: Kryenaltësija

Dispozicjoni:

Kryenalti dhe mënyra e të sjellurit të tij. — Dëmet e kryenaltësis — Ndashkimet e kryenaltësis. — Pse kryenalti ka karakter të dobët. — Burimet e kryenaltësis. — Në ç'raste duhet të jemi kryenaltë?

Mësimi i moralit është abstrakt dhe prandaj pak i vështirë për t'u kuptuar nga nxënësi i filllores. Si çdo mësim tjetër abstrakt, edhe ky, do të konkretizohet, me anën e shëmbëllave që të hyjë sa më lehtë

në mendje të nxënësve dhe të bëjë efektin e duhur. Morali mësohet që të praktikohet në jetë prandaj duhet që ç'do këshillë të jetë e shoqëruar prej shëmbëllës.

Forma më mirë e mësimit, qi duhet përdorur në moral, është forma "biseduese", duke e ndërruar në formë kallzuese vetëm kur të tregohen shëmbëllat nga mësuesi. Procedimi do të jetë: nga shëmbëlla në përfundim. Në këtë mënyrë jo vetëm që lehtësohet kuptimi i mësimit, por edhe nxiten nxënësit të mendojnë mbi pasojat e ngjarjevet. Kështu përmbushet edhe një nga qëllimet kryesore të mësimit: të mprepurit e gjykimit.

Hyrja — Mësuesi trillon një ngjarje të vogël ku përshkruhet zënëja e dy djemvet ndër të cilët njëri është kryenalt. Passi përshkruan djaln kryenaltë në mënyrë të theksuarëshme, që të kuptohet prej nxënësve vesi i këtij, i pyet nxënësit: Kush do të më thotë ç'njeri ka qenë ky? Ç'farë vesi ka pasur? Nx. . . . Mës. përse ka qenë kryenalt? Nx.

Paraqitja Mës A keni pa ju ndonji njeri kryenalt? Nx. Mës. . . . ka shumë njerëz që janë kryenalt burra dhe gra por më tepër ka fëmijë, djem të rinj që janë kryenalt. Kush do t'i thotë mësuesit se ku e kuptojmë një njeri që është kryenalt? Nx. (Në këtë mënyrë vijmë në shënjat e kryenaltësis dhe sjelljet e kryenaltit: mbâhet rëndë, nuk u-flet të gjithve, lëvdon vehten, gjithënjë nuk pranon gabime)

Për të kaluar në dëmet që sjellë kryenaltësija, si mbas procedimit që treguam në hyrje, kallzohet nga ana e mësuesit një shëmbëll morali. Në këtë shëmbëll morali i marrun nga istorija a Leteratura përshkruhet një kryenalt me sjelljet e tij.

Në këtë kallzim të vogël krijohet "njeriu tip", i mësimit të moralit. Duke theksuar dëmet që pësoi ky "njeri tip", i kryenaltësis do të arrijmë, në bashkupnim me nxënësit, në përfundimet e këqija të kryenaltësis. Passi të bëhen këto atëhere fare lehtë mund të përgjithësojmë të metat e kryenaltësis.

Mës. Pra ç'kuptojmë ne nga jeta e këtij njeriu? Ç'na bje kryenaltësija? Nx... Mës. Po kryenaltësia na bje shumë dëme, kush do t'i thotë mësuesit një nga këto dëme? Nx... kryenaltin e urrejnë të gjithë. Mës. si rron ay që urrehet nga të gjithë? Nx... Mës. Edhe një të metë tjetër të madhe ka kryenaltësija. Nx... Mës.... Thamë se kryenalti lëvdon vet-hen edhe për të lëvduar vet-hen ç'bën? Nx... M. Ay shumë herë shan të tjerët dhe zihet me 'ta. Mësuesi, ndër dëmet e kryenaltësis, nuk harron t'ju përmendi edhe t'ju theksojë një të metë me rëndësi kryesore: kryenalti e quan vet-hen më të zot se kushdo; në këtë mënyrë nuk pranon gabime. Nuk pyet të tjerët për të ndrequr gabimet kështu që nuk përmirësohet; në të shumtat e punëve, që bën, duke kujtuar se i din të gjitha, gabon shumë herë dhe dëmtohet.

Mës. Njerëz kryenaltë jo vetëm që ka tani, po ka pasë edhe përpara në kohërat e kaluara. Akemi përmendur ndonji njeri në Histori që ka qenë kryenalt.? Nx. Teuta. Mës. Po, Teuta ka qenë një mbretëreshë kryenaltë. Ku u-tregua ajo kryenaltë? Nx... (Lihen nxënësit të përshkruajnë konfliktin që ngjanë midis Teutës dhe Romanëve. Në këtë theksohet pasoja e dëmshëme që pruri për Teutën ky konflikt: Ja pra që kryenaltësija na sjellë shumë herë edhe ndeshkime të rënda.

Mës. A kini vënë re se kush është më kryenalt? Nx... Mës. kryenalt më shumë janë budallenjt. Njerzit e mençëm nuk janë

kryenaltë. Budallejt nuk dijnë se sa vlejné dhe krenohen, që kështu i urren më tepër bota. A keni pa kallirin e gurrit të papjekur si rri Nx... Mës. Po rri me kokë përpjetë. Mës. a ka kokërra brenda kalliu i pa pjekur? Nx. Jo. Mës. Po kalliu i pjekur si qindron? Nx... M. kalliri i pjekur, që është me plot kokra, ka kokën të unjur poshtë.

Ky krahasim bëhet që t'iu theksohet edhe më tepër se njerzit budallenj janë kryenaltë, kurse të mençmit jo! Pas kësaj mësuesi u këndon dy vargje të poetit t'onë Naim Frashëri, ku flitet mbi kryelartësinë.

Mës. Po kur themi se nuk duhet të jemi kryenaltë nuk duam të themi se lipset të jemi t'ulët. Nga një herë duhet të jemi kryenaltë në disa raste. Nx... Mës. Na duhet të jemi pak kryenaltë se jemi Shqiptar; rraca Shqiptare ka shumë virtyte të mira. Kush do t'i tregojë mësuesit disa nga këto? Nx... Besa, nderi, burrërija Mës. Në ç'rasë të tjera duhet të jemi kryenaltë? Nx... Mës. Duhet të jemi kryenaltë kur bëjmë ndonjë vepër të mirë njerëzore; kur përpiqemi për ndonji të vërtetë, ose kur mbrojmë një të drejtë.

Në funt, në qoftë se lejon koha, bëhet një përsëritje përmbledhëse e lëndës së shtjelluar.

V. R. Gjatë mësimit të moralit është mirë të përdoren dhe "fabla", të goditura për këtë qëllim prej shkrimtarëve më të zotë. Të mira janë ato të moralistit freng La Fontaine, që i ka përkthyer në Shqip "Çajupi".

Normalisti '37.

Anekdotë

Pergjigje e hollë

Në kohë kur Napoleoni ishte akoma oficer i artileris, një oficer Prusian thoshte përpara tij me mburrje që bashkatdhetarët e tij luftojshin për famë, kurse Frengjt luftonin për parë. — "Kini mjaftë të drejtë, i u-përgjegj Bonaparti, secili lufton për të fituar ç'ë mungon .."

M. Ed. Herriot ka thënë: "Kur arësen, nuk mbush një kupë, po ndes një vatër .."

Novelë

Mësonjësi i vjetër rrëfëhet!

Nënë përlëshjen e mendimeve pedagogjike pa dashur më del përpara syvet fytyra shumë e vuajtur e Xha Nelos : sy fellë, hundë-shtypur e fytyrë-thatë : njeri i rahur me vaj e me uthull, e përnjëherësh kujtimi, që lidhet me 'të, ngre krye dhe ngjarjet si në realitet po i përshkon truri i em.

Xha Nelua! Ja, sikur e shoh përpara meje herë të dëshpëruar dhe herë të qeshur; herë dyke kënduar dhe herë dyke pirë duhan. Atje larg në vetmin e fshatit, ku mungonte çdo mjet dëfrenjës, Xha Nelua për mua ishte një botë e tërë, ku çfletësonje të shkruar. Dhe pse jo : dyke u-endur mbrëmje-për mbrëmje mbi livadhet e gjelbëruar, kënaqesha dyke dëgjuar ngjarjet e jetës së tij; këto ngjarje sikur të përmbli-dhen pa dyshim do të formojnë romancin e vërtetë të njëj fat-ziu, që ka ardhur në botë për t'u përplasur andej-këndej nga njerëzit ! Por me gjithë mynxyrat e tij të përjetëshme, këngën s'e kishte lënë: ndoshta ishte **gëzimi i lindur** nga mjerimet pa fund, por... një herë ai këndonte, këndonte shumë bukur lapçe e me atë melodi të fuste në një botë, ku çdo gjë të tërhiqte përmallëshëm! — Një herë edhe unë kam qënë mësonjës. — më tha një mbrëmje, kur po flisnim di-çka për punë arsimore. — Se si më emëruan edhe sot bile s'e kam kuptuar akoma; dij vetëm se disa javë, mbassi u-këtheva nga Misiri, më erdhi lajmi për mësonjës në katundin K. Të them të vërtetën : Ky lajm më gëzoi pa masë jo për gjë tjetër, por pse hopa-hopa fare lehtë do të mblidheshin napolonat në xhëp. Vajta në katund pa bërë naze fare. Atje banorët ishin gjysmë muhamedanë e gjysmë të krishterë, prandaj për mësonjës ishte edhe një hoxhë. Mësimet me hoxhën i kishim bashkuar, vetëm se punën e bënim me radhë para dreke bënja mësimin unë e mbas dreke bënte ai. Për shkollë kishin një dhomë

pranë xhamisë. Por edhe ç'Shköllë se: kishte dy penxhere si brimëza koteci, muret ishin të paljera dhe vënde-vënde kishte gurë të rrëzuar e gropa të hapura; çatia, që ishte në vënd të tavanit, dukej shumë e shëmtuar me ato trarë e me ata hunj të hedhur në drejtime të ndryshme; pale pastaj me atë tym e me atë blozë, që mbante, dukej tamam si qiell skëtere. Dushemeja ishte e shtruar me dhë e aty-këtu kishte gropa të gërmuara si me turinj dërrësh! Merimangat më çdo kënd kishin endur pëllhurat e tyre. Kjo dhomë nuk ishte vetëm si vënd mësimi, por edhe si vënd banimi i jonë. Më një kënd kishim vënë teshat t'ona edhe në këndin t'jetër u bënim mësim nxënësvet. Bukën edhe gjellën i gatuanim vetë po në këtë dhomë; kur gatuanja unë bukën, hoxha bënte gjellën, bënim edhe përkundrazi Çdo gjë pra me radhë; edhe ujë mbushnim me radhë edhe zjarrin e ndiznim me radhë, edhe fshinim me radhë. Shtresat t'ona lërë mos e nga se si ishin : Kishim të shtruar nja një rrogoz të shpartalluar edhe nga një thes të leckosur, për mbulesë kishim nga një levence e mbytur me pluhur. Nxënësit ishin të palarë, të leckosur, të zbathur, të ndyrë, me hundë të pafshirë e me morra : një erë e qelbur kundërmonte nga trupi i tyre!

Për mjet mësimi s'kishim as gjë: as banga, as drasë të zezë, as shkumës etj... ; edhe nxënësit vetë s'kishin as pllakë, as kalema, as radhonj e as abetare. Në një strajçë të madh gadi si thes — që e mbanin gjithënjë në qafë, kishim nja dy-tre thëngjij në vënd të kalemit edhe nga ndonjë copë letër ngjyrë-bardhë, e kuqe a e verdhë nga ato që mbëshijellin tregëtarët plaçkat, që shesin.

Kur bënja mësim unë, hoxha shtrihej te këndi tjetër dhe **paf-puf** thëthinte duhanin. Herë herë trazonte zjarrin, që të

zënin lasulet e drekës, a shëkonte nëtë saç bukën në shtëpiqë mirë. Kur e shikonte se buka piqej mirë, lasulet lëshonin urtë të këndëshme, i shtrinë si ishte me pipën në gojë e dykte qeshur thënishte:

— Ama sot e ke qurë fare këttë çyrek, aqë i mirë duket! — e te fillonin të qeshnin: qeshnin se bashku me thënisht e me hrahën.

Kur fillonin mësimin, asnjë nga thënisht mëndjen nuk e kishte në mësim: disa përkasin shokët, disa i thënishtin mbas këmbës a mbas gulltas shokët e tyre, disa gdhëninin këqta kat-na-si kufi, disa lëshohëllenin e disa me gjisht i tregonin tjeri tjetrit momat e shokut, kurse haxha vijonte buazin e tij:

— Sot kemi lasule të mirat! Buka u poq fare mirë!

Gjithë mësimi një zburonë e vaxhëuarstine dhe e mërzitëshme ndihej, as një përshytyje s'a bënte qortimi e shokqi i mësimjesh. Kur naha naha një, të tjerët, në vend që të përbëdhëshin, shkuleshin së qeshuri. Gëzimi më i orath i tyre ishte, kur qante ndo një shok nga të raturit por përlëshija shtëtej edhe më: disa bënin sikur qanin, disa zburonin dhembët e disa thënisnin: O burra tjerë! Ha, ha! O, o, o! Kështu de! Bjeri edhe një herë... edhe një për mua, se që parë më shqyrë! As drejtji s'i vinte në qetësi.

Edhe ora e shtrimit kishte buazin e saj: astu këndë kryq si rinin, me thurme të madhe natrin nga trajta çyqën e lehtë edhe thëngjillin, pastaj po me atë thurme të ngutërëshme fillonin jo të shkruanin shkruajtën që a caktoja unë, por të bënin shtrak shtrak vija e melle pa as një kujtim, mirpo për ata këtu vija e melle të gramvulluara ishin njerës, shqipi, kalshë eji, edhe, dykte u-nburur, ia tregonin shoqi shoqit.

— Ja sa bukur e bëra suratin t'ënd! — Pa shëko se sa të fortë e bëra gomarin t'ua! eji, eji i thashnin shoqi shoqit, e ora mburonte pa as një përfundim. Kur i

lëshonin nga shkolla, kishin përsëri buazin të ri: Disa kat-na-si kufi kapesthin hë për hëti, disa të tjerët përlësheshin me të shart, disa hiqonin nëpër dhomë strajcat, letrat a thëngjijtë e shokëve e të mbeturit ankudeshin, ankudeshin për të shqyqën e për përkimim e shokut, për letrën e gësurr a për opitngat e shëhetur! Me përlëshetje, me të shtëqë e me të thurur ilmin për në shqyqë, kurse te — mësimjesh e këtyre themjëve — përgara zburonës së madhe ose do të përdurimin pa kursim shtrëth, shuplakën e shkelërnë, ose do të rinin të hutuar pa lëvizur fare nga vendi. Tërë vitin këstua e kaluan. Kur u-mbyll shkolla nga të 50 thënisht veftim dhietë thënisht dmin të shkruanimit gjishtë shkruajta, pesë mbëdhinëft dmin veftim nga një shkruajë e të tjerët nok dmin asnjë: ky ishte përdurimi i vitë shkollor. Përfundimi nuk ishte aqë i mirë, por ç'është bënim, bën s'e kishim ne: në oim! në punë të tëra mundimet edhe dërimet por... përsëri punën s'e bëjnë astu si duket. Nuerëst ishin të trashë nga mëndja! Sa për inspekturin, këttë s'na e zuri syri kurte: bile unë nuk mund ta mendroja se ç'ajeti do t'ishte ky inspektur shkollor! E, sa për zhandurin, ky s'na ndahej: për te zhanduri ishte inspektori i shkollës: sa herë na vinte në klasë unë me hrahën dhëdheshim nga frika, por edhe thënisht rinin urtë. Kur largohet ai, thënisht fillonin përsëri nga thurma, kurse unë me hrahën lëshonin dhart dykte thënishtë: — nuk na fali gjë: Duket se mbeti shumë i kënaqur!

Si do qitë puna, për hesapin t'em vitin e kalova fare mirë: shumë parë kisha kursyer nga moga edhe me hrahën jetuam si vlerë.

Mandëj si i menduar shtëri: — Për hrahën më ka marrë malli shumë i Gjithënjë e kujtoni, Deft hrahë Ah-met! — Pshërhëlli e pastaj heshti. U-nisëm për të hitat, por ai magës astijë fjalë nuk fali: duket shumë i prekur nga kujtimi i bashkë-punëtosh të 'ij të njëpërlëshëm.

Novelë

Mësonjësi i vjetër rrëfëhet!

Nënë përleshjen e mendimeve pedagogjike pa dashur më del përpara syvet fytyra shumë e vuajtur e Xha Nelos : sy fellë, hundë-shtypur e fytyrë-thatë ; njeri i rahur me vaj e me uthull, e përnjëherësh kujtimi, që lidhet me 'të, ngre krye dhe ngjarjet si në realitet po i përshkon truri i em.

Xha Nelua! Ja, sikur e shoh përpara meje herë të dëshpëruar dhe herë të qeshur; herë dyke kënduar dhe herë dyke pirë duhan. Atje larg në vetmin e fshatit, ku mungonte çdo mjet dëfrenjës, Xha Nelua për mua ishte një botë e terë, ku çfletësonje të shkruar. Dhe pse jo : dyke u-endur mbrëmje-për mbrëmje mbi livadhet e gjelbëruar, kënaqesha dyke dëgjuar ngjarjet e jetës së tij; këto ngjarje sikur të përmblihdhen pa dyshim do të formojnë romancin e vërtetë të njëj fat-ziu, që ka ardhur në botë për t'u përplasur andej-këndej nga njerëzit ! Por me gjithë mynxyrat e tij të përjetëshme, këngën s'e kishte lënë; ndoshta ishte **gëzimi i lindur** nga mjerimet pa fund, por... një herë ai këndonte, këndonte shumë bukur lapçe e me atë melodi të fuste në një botë, ku çdo gjë të tërhiqte përmallëshëm ! — Një herë edhe unë kam qënë mësonjës. — më tha një mbrëmje, kur po flisnim diçka për punë arsimore. — Se si më emëruan edhe sot bile s'e kam kuptuar akoma; dij vetëm se disa javë, mbassi u-këtheva nga Misiri, më erdhi lajmi për mësonjës në katundin K. Të them të vërtetën : Ky lajm më gëzoi pa masë jo për gjë tjetër, por pse hopa-hopa fare lehtë do të mblidheshin napolonat në xhep. Vajta në katund pa bërë naze fare. Atje banorët ishin gjysmë muhamedanë e gjysmë të krishterë, prandaj për mësonjës ishte edhe një hoxhë. Mësimet me hoxhën i kishim bashkuar, vetëm se punën e bënim me radhë para drekte bënja mësimin unë e mbas drekte bënte ai. Për shkollë kishin një dhomë

pranë xhamisë. Por edhe ç'Shokllë se: kishte dy penxherë si brimëza koteci, muret ishin të palyera dhe vënde-vënde kishte gurë të rrëzuar e gropa të hapura; çatia, që ishte në vënd të tavanit, dukej shumë e shëmtuar me ato trarë e me ata hunj të hedhur në drejtime të ndryshme; pale pastaj me atë tym e me atë blozë, që mbante, dukej tamam si qiell skëtere. Dushemeja ishte e shtruar me dhë e aty-këtu kishte gropa të gërmuara si me turinj dërrësh! Merimangat më çdo kënd kishin endur pëllhurat e 'tyre. Kjo dhomë nuk ishte vetëm si vënd mësimi, por edhe si vënd banimi i jonë. Më një kënd kishim vënë teshat t'ona edhe në këndin t'jetër u bënim mësim nxënësvet. Bukën edhe gjellën i gatuanim vetë po në këtë dhomë; kur gatuanja unë bukën, hoxha bënte gjellën, bënim edhe përkundrazi. Çdo gjë pra me radhë: edhe ujë mbushnim me radhë edhe zjarrin e ndiznim me radhë, edhe fshinim me radhë. Shtresat t'ona lër-e mos e nga se si ishin : Kishim të shtruar nja një rrogos të shpartalluar edhe nga një thes të leckosur, për mbulesë kishim nga një levence e mbytur me pluhur. Nxënësit ishin të palarë, të leckosur, të zbathur, të ndyrë, me hundë të pafshirë e me morra : një erë e qelbur kundërmonte nga trupi i 'tyre !

Për një mësimi s'kishim as gjë: as banga, as drasë të zezë, as shkumës eij...; edhe nxënësit vetë s'kishin as pllakë, as kalema, as radhoni e as abetare. Në një strajcë të madh gadi si thes — që e mbanin gjithënjë në qafë, kishim nja dy-tre thëngiij në vënd të kalemit edhe nga ndonjë copë letër ngjyrë-bardhë, e kuqe a e verdhë nga ato që mbëshijellin tregëfarët plaçkat, që shesin.

Kur bënja mësim unë, hoxha shtrihej te këndi tjetër dhe **paf-puf** thëthinte duhanin. Herë herë trazonte zjarrin, që të

zienen fasulet e drekës, a shkënte nënë saç bukën në së piqej mirë. Kur e shikonte se buka piqej mirë, fasulet lëshonin erë të këndëshme, i shtrirë si ishte me pipën në gojë e dyke qeshur thërriste:

— Ama sot e ke qarë fare këtë çyrek, aqë i mirë duket! — e ne fillonim të qeshnim: qeshnim se bashku me nxënësit e me hoxhën.

Kur fillonim mësimin, asnjë nga nxënësit mëndjen nuk e kishte në mësim: disa pickonin shokët, disa i tërhiqnin mbas këmbëshë a mbas palltos shokët e tyre, disa gdhendnin kleçka kot-na-si koti, disa fërshëllenin e disa me gjisht i tregonin njeri tjetrit morrat e shokut, kurse hoxha vijonte havazin e tij:

— Sot kemi fasule të mira! Buka u poq fare mirë!

Gjatë mëimit një zhurmë e vazhduarshme dhe e mërzitëshme ndihej; as një përshtypje s'u bënte qortimi e shkopi i mësonjësit. Kur rihnja ndonjë, të tjerët, në vënd që të përmblihdeshin, shkuleshin së qeshuri. Gëzimi më i math i tyre ishte, kur qante ndo një shok nga të rahurit: por përleshja shtohet edhe më: disa bënin sikur qanin, disa zbardhnin dhëmbët e disa thërrisnin: **O burra bjer-i! Ha, ha! O, o, o! Kështu de! Bjeri edhe një herë, . . . edhe një për mua, se që për më shtyri!** As dreqi s'i vinte në qetësi.

Edhe ora e shkrimit kishte havazin e 'saj: ashtu këmbë kryq si rinin, me zhurmë të madhe nxirnin nga trajca copën e letrës edhe thëngjillin, pastaj po me atë zhurmë të ngaherëshme fillonin jo të shkruanin shkronjën që u caktonja unë, por të bënin shtrak shtruk vija e rrethe pa as një kuptim; mirpo për ata këto vija e rrethe të grumbulluara ishin njerës, shtëpi, kafshë etj. edhe, dyke u-mburur, ia tregonin shoqi shoqit.

— Ja sa bukur e bëra suratin t'ëndi! — Pa shëko se sa të fortë e bëra gomarin t'uaj! etj., etj. i thoshnin shoqi shoqit, e ora mbaronte pa as një përfundim. Kur i

lëshonim nga shkolla, kishin përsëri **havaz** të ri; Disa kot-na-si-koti kapeshin fyt për fyt, disa të tjerë përlesheshin me të sharë, disa hidhnin nëpër dhomë strajcat, letrat a thëngjijtë e shokëve e të mbeturit ankoeshin, ankoeshin për të shtyrën e për pickimin e shokut, për letrën e grisur a për opingat e fshehura! Me përleshje, me të shtyrë e me të thirur iknin për në shtëpi, kurse ne — mësonjësit e këtyre fëmijëve — përpara zhurmës së madhe ose do të përdornim pa kursim shufrën, shuplakën e shkelmën, ose do të rinim të hutuar pa lëvizur fare nga vëndi. Tërë vitin kështu e kaluam. Kur umbyll shkolla nga të 50 nxënës vetëm dhietë nxënës dinin të shkruanin gjashtë shkronja, pesë mbëdhietë dinin vetëm nga një shkronjë e të tjerët nuk dinin asnjë: ky ishte përfundimi i vitit shkollor. Përfundimi nuk ishte aqë i mirë, por ç'të bënim, fain s'e kishim ne: ne vinin' në punë të tëra mundimet edhe dënimet por . . . përsëri punën s'e bëjmë ashtu si duhej. Nxenësit ishin të trashë nga mëndja! Sa per Inspektorin, këtë s'na e zuri syri kurrë; bile unë nuk mund ta mendonja se ç'njeri do t'ishte ky inspektor shkollë! Ë, sa për zhandarin, ky s'na ndahej: për ne zhandari ishte inspektori i shkollës: sa herë na vinte në klasë unë me hoxhën dridheshim nga frika, por edhe nxënësit rinin urtë. Kur largohet ai, nxënësit fillonin përsëri nga zhurma, kurse unë me hoxhën fërkonim duart dyke thënë: — nuk na foli gjë: Duket se mbeti shumë i kënaqur!

Si do qoftë puna, për hesapin t'em vitin e kalova fare mirë: shumë parë kisha kursyer nga rroga edhe me hoxhën jetuam si vllëzër.

Mandëj si i menduar shtoi:

— Për hoxhën më ka marrë malli shumë! Gjithënjë e kujtonj. . . . Deh hoxhë Ahmet! . . . — Psherëtitë e pastaj heshti. U-nisëm për në fshat, por ai rrugës asnjë fjalë nuk foli: dukej shumë i prekur nga kujtimi i bashkë-punëtorit të 'tij të njëherëshëm.

St. Spasse '32.

Një konferencë Pedagogjike.

Më 3 të këtij muaji Z. Shaban Arra, mësues në Ushtrimoren e Shkollës s' onë, mbajti një konferencë pedagogjike në sallën e Kinemas "Nasional". Përveç arësimitarëve të këtij qyteti, të cilët u ndodhën aty, pa përjashtim, konferencën e dëgjuan dhe klasat e epërme të shkollës s' onë. Tema e konferencës u shvillua reth këtyre pikave: **E mësuesja: një vepër arti, një vepër dije, një vepër morali.** Me gëzimin më të math po shënojmë këto radhë: është një "sahariq", për neve kur digjojmë se edhe konferenca pedagogjike të tjera do të mbahen në qytetin t' onë. Te kësaj konferenca dëshërojmë t' i botojmë tërësisht në të përkohëshmen t' onë; mirpo për këtë radhë mungesa e vëndit na shtrëngon të kufizohemi me një koment të shkurtër.

Duhet thënë që në fillim: konferenca ka qënë një studim i vë tetë. Në të përmbledheshin, përveç verëjtjeve të hartonjesit, edhe mendime pedagogjesh me emër. Përsa i përket pikës së parë: **E mësuesja, një vepër arti** konferencieri, midis të tjerave, tha:

E mësuesja asht një art i shejt i cili mirëhet me ma të natat qëllime, me humanitetin vetë e me lëndën ma fisnike e ma bujare, me shpirt njeriu; një art serioz kulmit e superioritetit të të cilit i mirëhet vetëm me të dhanun me shpirt, me mund e me qindresë. Një art plot gëzim për atë që beson në një ideal, që beson në një zhvillim dhe përmirësim të kulturës e që, tue pasë një njohuni të botës së jashtëme e një mësim intuitiv të jetës një cak dhe një parim mbas të cilit do të

jetojë **E mësuesja asht një art i lirë** kur shpirti punon ma tepër se dora e në të cilën mbretënojnë jo ligje të thahta, por ligje të gjalla e të ndishme për secilin njeri ..

Më poshtë na thotë se mësimi ka ligjet e tij pra, është një vepër dije; mësimi nuk grumbullon njohni, por shjtëllon fuqi, pra formon. Këto konferencieri na i paraqet krijelltas. Mendimet e 'tij nga njëherë shfaqërohen nga opinione "autoritetesh", pedagogjike si Dr. Adolphe Ferrière, Dr. Friedrich Paulsen, etj.

Dhuanin' e artit nuk e kanë të gjithë; dhe atëhere janë të denuar? Jo! Ja se si na dëfton mënyrën me anën e secilës ata do të fitojnë cilsinë që përpara u mungonte, cilsi q' është e domosdoshme për karrierën e mësuesit.

"Tue hye thellë n' ai, të cilit i mungon dhantija e artit — e këta janë shumë ndër né — ndër mësheftesitë e jetës së shpirtit e të zhvillimit të sajë, tue kërkuem dhe tue i provuim mjetet që i paraqiten, tue vretë ai vetë, tue i mbledhë e tue i shumue exsperienat tue u thelluem ndër veprat e 'tyne te cilat ai i ka njoftë si mjeshtër, ai po, mrrin me e zavëndesue dhe me e përmirësue n' atë dhanti arti që s' e kishte përpara.."

Passi na dëfton arësien pse e emësuesja është vepër morali thekson virtutet e mësuesit: **besniki ne detyrë, kujdes në përgatitje, sakrificë vëhtjake, qindresë të madhe.** Arësimitari i dha funt konferencës së 'tij të dobishme me këto fjalë plot kuptim: një mësues, që ep vetëm dije, asht një mjeshtër zanatlli, një mesu s, që përpiqet me trajtuem karakterin, asht vërtet një artist ..

Në një klasë të mbaruar duhen vetëm aktorë dhe jo spektatorë, cilido duhet të lozë rolin e 'tij.

(A. Vessiot)

G. Leopardi

Nerina.

O Nerin!¹⁾ e për ty ndoshta s' i ndiej këto vënde me fol' ? fikë ti ndoshta prej mëndimit t' em jë ? Ku më ke shkue, qi ktu vetëm kujtimin t' and po gjej, moj ambëlsina e eme ? Nuk po të shef vëndi ku u-linde : ajo dritësore, prej së cilës ti ishe msue me m' folë, e prej kah zym't²⁾ shëndrit e hyjvet rrezja, ásht e shkret'. Ku më jë qi má s' po e ndiej zánin t' and të tinglloi si kúr nji herë zakon' e kishe çdo tingull sa do i largët prej buz'sh t' ua. qi ke un mbërrinte, ftyrën tue m' a zbé ? Koha tjera.³⁾ E ditët t' ua qën' dashunij' e eme. Kalove.⁴⁾ E të tjerë sot e kan radhën me kalue mbi tokë⁵⁾ e me i banue këto kodra t' erandshme. Por ti shum' shejpt kalove;⁶⁾ e si nji ándërr qe jet' e jote. Atje tue vallzue; n' ball gzimi të shndritte, ndritte në sý t' tú ai trill me plot shpëresa, ajo dritë e rinis qi ty fati t' i shuëjti

Për tok' rë Ah o Nerin! N' zëmer m mretnon dashnija e vj-ter. Kúr ndo'i herë nder festa e ndër mbledhje endé shkoj, un me vehte thom: O Nerin', ndër mbledhje e ndër argtime ti nuk stolise má, ti nuk dredh valle. Kúr të kërthei prap Maji e gëma e kángë shkojn' tuj ja u-çue vashave dashnorët, thom: O Nerin' e emé, s' ka për ty má Prandver', má nuk kihen për ty dashtni. Çdo ditë të kthjellët, çdo rranzë deti t' l'ulzueme q'un t' sodis, çdo gzim q'un t' ndiej, thom : Nerina tash má nuk gëzon : fushat, ajrin nuk i kundron. Ah, ti kalove për jet' o frym' e shpirtit t' em kalove e shok

¹⁾ Nerina : Asht personifikimi i rinis qi lshohet në botë me gjith' ándrrat e veta dhe asht shitue prej vdekjes — ²⁾ Zym't : Pse dritorja tash ásht e shkretë. — ³⁾ Koha tjera : Nji kohë krejt e ndryshme nga e tashmja Shënon frazat e shkurtina e të këputuna prej vajit. — ⁴⁾ Kalove : Forcon vështrimin e përparshëm. :Jeta njerzore ásht e përfueme si nji kalim, toka si nji vënd kalimi. — ⁵⁾ Tokë : Jeta në kët botë, qi joshë e mashtron me bukurin e vet

i çdo trilli t' em t' kandshem, tan' ndiesive t' mija t' njoma dhe t' dashuna e t' tristueshme dal' prej zëmre, kujtim' i idhët ka me qenë.

⁶⁾ Kalove : Përsërit idén : të gjithë do të vdesin. Por ti ke vdekë shum' shejpt.

E përktheu : Ihsan Podgorica

Lëvizje edukative

Gjenevë :

Më 13—18 Korrik 1936 u-mbajt në Gjenevë e Pesta konferencë Ndërkombëtare e Arsimit. Ndërmjet të tjerash u bisedue edhe çeshtja e arsimit ndër katunde, ku u-vendos edhe :

Që mësuesit e katundeve të përdorin lehtësit didaktike që u lejon rrethi në të cilin gjinden dhe t' i japin shkollës nji karakter të gjallë jete tue zhvillue ndër nxënës shija e jetës së katundit.

Që në programet e katundeve të ketë nji vend të posaçëm për mesime rreth njohnivet mbi jetën e katundit.

Që nxânësve të katundit, veç mësimevet krejt bujqësore, t' u epet edhe njohni shkencore e má tepër njohni mbi mjetet má të reja që zotnon sot shkenca për nji përfundim má të mirë të punës bujqësore.

Që numuri i shkollave njklasëshe të zvogëlohet sa të jetë e mundun dhe për këtë të krijohen shkollat " qendrore " tue sigurue mjetet e udhëtimit.

Që veç shkollave fillore t' ulta të ketë edhe fillore të nalta, ku të epen në nji mënyrë má të gjënë se ndër qytete, njohni mbi përgatitjen dhe përmirësimin e jetës së katundeve.

Që mësuesit e katundeve mos të jenë në nji nivel má t' ulët se ata të qyteteve.

Që nji përgatitje e posaçme të jetë për mësuesit e katundeve, tue u mësue këtyneve má tepër njohni në lidhje me jetën e katundeve dhe mësuesvet njohni shtëpia-ke.

Që të vihen në zbatim stazhe mbi bujqësi e ekonomi shtëpiake për mësuesit e mësueset e mësimit jasht shkolluer.

Që mësuesvet të katundeve t' u bâhen mjaft lehtësina për t' ua lehtësue jetën e vështrirë larg qytetit biblioteka, radio, cinema etj.

Shënimet e Redaksisë.

Bibliografi

Në numërin që shkoi, kur përmendëm disa botime pedagogjike që na kanë arrijtur në zyrë, lamë pa shënuar dhe një broshurë të vogël të Z. Nuçi Kondili me titull „Faqe të pedagogjis Moderne„. Në këtë libërth auktori na jep shkurt disa njoftime mbi shkollën aktive dhe se si kupto het kjo në vëndet e ndryshme. Veç kësaj na flet pakë edhe mbi disa methodha edukative si ajo e Decroly, Montessori, etj.

Broshura në fjalë shitet kudo 1 lek.

Ndeshjet Sportive

Këto ditë mbaruan ndermjet klassëve ndeshjet e foot-ball-it. Ndeshjet u bënë me „revanche„ ndër mjet të klasës I, II e III. E para doli klasa e III me 5 pika e dyta doli klasa e II me 4 pika. Ndeshjet e footballit u ndoqën me interes prej nxanësve dhe u zhvilluan në harmoni të plotë si kundër u ka hije Normalistëve.

Më interesante ka qenë ndeshje e parë midis të II e III ku fitoi e III.

Edhe loja voley-ballit mori fund. Ne kete lojë e para u klasifikua klasa e II e dyta klas e I.

1937...

Ka mbetur zakon që në Normale të festohet shumë viti i ri. Interesim më të math për të bërë gati dhe për të rregulluar festën e dëftën rendi i fundit, d. m. th. ay rend që emrohet me emrin e vitit të ri.

Sivjet rendi '37 e rregulloi mirë festën e Vitit të ri. '37 ta na solli ndër mënt dhe një herë disa festime të bukura që janë bërë 3-4 vjet më parë n'Internat.

Programi i festës që i rregulluar mirë dhe kishte gjëra te ndryshme brënda. Në mbërmjen e 31 Dhjetorit ishin mbledhur të gjithë në sallën e bukës. Na kishin ardhur dhe miq, ndër 'ta dhe prof Z. Vasil Andoni. Herën e parë foli nendrejtori Z. Dr. Kamsi, që mbas disa keshillave të bukura u uroi nxanësve vitin e ri.

Mbas ligjeratave filloi koncerti. Koncerti kishte mjaft vegla dhe lozi shumë pjesë.

Pas pjesës së parë te koncertit u çfaq farsa „Osman Opingaxhiu„. Këtu na lodhi së qeshuri Matija, që loste rolin e

Osmanit.

U los pastaj pjesë e dytë e koncertit e nja dy solo prej Bumçit '37.

U çfaq në sgenë një copë melodrami ku u këndua prej I. Podgoricës '39 kenga „Hijet e zeza„.

Kur ra ora dymbëdhete ngrihet perdja dhe duken ne skenë nxenësit e '37. Heshkje, duartrokite nga ana e nxenësve.

Në mes te gazit e të kënaqësis u ndanë dhe dhuratat e vitit te ri dhe palat e arrat.

— Festa e vitit ri ka mbetur si një nga festat që lidh më fort Normalistat-mësuës me Normalistat-nxënë. Normalistat-nxënë këtë natë i kujtojnë të gjithë ata që kanë rregulluar këtë festë medje dhe krahësojnë rregullimin e një klase me tjetrën etj. Po edhe Normalistave-mësues nuk u harrohet më duket kjo festë. Ata nga qyteti a po nga vetmi e katundit na kujtojnë.

Sivjet ca Normalistë na shkruanin e na uronin vitin e ri. Normalisti i falnderon.

Vitin e ri u uronte nxenësve nga Vlorë dhe ish-nendrejtor Z. Dr. Stiliano Gaxho Urimi u prit me duartrokite nga nxënësit.

Normalisti e falënderon Z. Doktor.

Grumbullim' i libravet.

Bibliotheka „Normalisti„ e themeluar disa kohë më parë, shkon duke u-pasuruar. Gjatë muajit që shkoi libra të tjera i janë dhuruar. Kush pak, kush shumë të gjithë japin „kontributin„ e tyre

Falënderojmë boterisht të poshtëshënuarit që na kanë dhënë më tepër se kushdo libra gjatë këtij muaji.

Z. Prof. Gaspër Ugashi

Z. Prof. Murteza Krasta

Nga nxënësit janë për t'u shënuar:

Remzi Merolli nxënësi i klasës VI

Eleonora Floqi „ „ VI

Nuçi Furxhi „ „ VII

Urim

Profesori i muzikës instrumentale, Z. Murteza Krasta u-fejua këto ditë „Normalisti„ i uron bashkim të shpejtë.

Posta e Jonë

P. T. Përpjekja Shqiptare — Tiranë. Muarmë Nr. 3. dhe Ju falënderojmë. Na dërgoni Nr. 1 dhe 2.

Z. S. Papahristo, Drejtor i Inst. " Nëna Mbretreshë „ Tiranë. Muarmë pajtimet dhe Ju jemi mirënjohës.

Z. Abedin Shkëmbi, Drejtor i Shkollës Bilisht. Erdhën të hollat; dëftesat Ju dërgohen.

Z. Ali Idrizi — Delvinë. Muarmë. Të fala.

Zonjushes Ballkëz Tela — Peqin. Muarmë dhe Ju falënderojmë.

Z. Sotiraq Paparisto — Gënéve. Me qenë se erdhi vonë mbetet për numërin tjetër. Presim.

Z. Lirak Dodbiba — Lyon. Presim nga Ju. Të fala.

Z. K. Vide — Fier. Një shok na tha diçka. Nuk kemi marrë gjë. Presim. Të fala.

Z. Z. Përfaqësonjësvet. Ju lutemi atyre përfaqësonjësvet të " Normalistit „ që u kanë tepruar copë nga numëri i parë të na i kthejnë, mbassi disa krahina na kërkojnë më tepër se ç' u kishim dërguar.

Ju lutemi Z. Z. bashkëpunorëve që shkrimet e tyre të jenë të qartë dhe të këndueshëm lehtë, mbassi ndjejnë vështirësi radhitësit e Shtypshkronjës.

Ndreqje gabimi.

Në kryeartikullin në fund të faqes 3 gabimisht është shkruar " trajtuar „ në vënd të fjalës " trajtue „.

Muzeu i Shkollës Normale

SHËNIM. — Me qënë se Folklori ka rëndësi të madhe vendosëm që, në çdo numër të së përkohëshmes s'onë, 4 faqe t'ia kushtojmë asaj. Fjalët që botuam në numërin e parë dhe këto që jemi duke botuar na i ka dërguar Z. Sotir Kolea, Drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Tiranës dhe një nga mbledhësit e thesarit t'onë gjuhësor. Si të mbarojnë fjalët e zotris së 'tij, kemi të tjera të qëmtuara në krahinat e ndryshme të Shqipërisë me kujdesin më të math. Këtu duam të theksojmë një gjë: ata që nuk i gjëjnë me vënd kuptimet e fjalëve le të hetojnë mirë mbi ndryshimet e 'tyre dhe le të na dërgojnë vrejttjet e duhura. Me qënë se puna bëhet për një shërbim të gjuhës duhet të pranojmë çdo kritikë ndriçonjëse (Red)

Fjalë të qëmtuara në rreth të Përmetitë me të kujdesurit të Zotit Pano S. Tase.

Kapso . . . : (fjalë e marurë nga greqishteja) e shtuarë në krye të një emëri, të njëj' fjale, u ep një kupëtim dobësimi, një kupëtim që rrëfen se ay sent, se ajo gjë nuk' është për të qënë, nuk' ka ndonjë vlejë; p. sh: Një kapso-njeri (= një qyqo-njeri, një njeri që s'ka ndonjë rëndësi: Ca kapso-bagëtitj; ca bagëtitj të krimbura).

Kapuç : i hapurë synë nga të përkëdhelurat' të prindërvetë; p. sh: E ka mësuar' i ati kapuç andaj' nuk' shkon me shokë.

Kacambasem : kacafytem; zihem (folitem; hahem me fjalë) me njërin' e me jetërinë; p. sh: Ukacambasën' keqë ata të dy.

Kollomaqe : latuijë (laturim) me baltë; p. sh: Ubë kollomaqe me baltë djali.

Kollonjgjisënj : Kredhënj nd' ujë; lagënj me ujë; bënj xurxullë; p. sh: Ukolonjgjis djali.

Kollonjgjisurë (i — —) : i kredhurë (i bërë qullë; i bërë xurxullë) nd' ujë.

Kullumbrisënj : kredhënj funt e krye nd' ujë; fundosënj brënda nd' ujë.

Kullumbrisurë (i — —) : i kredhurë (i shdukurë; i humburë; i fundosurë) nd' ujë.

Koriturë (i — —) : i kuriturë; i uriturë (i urëtuarë) për së tepëri; i marurë (i zënë) urija sytë.

Koritem : kuritem; më mer urija për së tepëri; më zën urija sysh; p. sh: Ukoritem për të ngrënë.

Korube (— ja) : arkë vajguri; Korubeja ka dy matara (dy pafilla, dy bakraçë) vajguri.

Krinë : koshere blete.

Kullusmë : sgëq ferrash, kulpërash dhe bimërash t' jera të ndërlikuara në mënyrë që njeriu nuk' munt të hynjë o të shkonjë për mes; p. sh: Njëpër kullusma bëjën' shtrokat' egërsiratë.

Kone (— ja) : qen i vogëlë; qen shtëpije që mbahet' vetëmë sa për të lehurë.

Konoçe : si kone.

Konishte : si kone.

Këlysh : pjella e bushtërësë.

Kulish : " "

Kylysh : " "

Kotele : pjella e macesë.

Kotole : " " "

Korçallë (— lla) : si dockë; misërishte.

Kollovar (shum. kollovarë) : pesë o gjashtë kallinjë misëri të lidhurë bashkë nga lëveshga! të tyre dhe të mvarurë nëpër trerë të shtëpijësë për t'u tharë.

Kolovatem : jam i varurë po gati për të rënë; jam në skandalijë; p. sh : Një koqe dardhë po kolovate! (mezi sa mbahet' në t'ëmënë); Shpëtoj' nga vdekja se ukolovat' nga një degë.

Kondur (— ri) : trunk lisi i hequr' në sëpatë për t'u vënë në sharrë për dhoga.

Kulumare : maja (kurrizi; krëhëri) i kulmit' të shtëpijësë (të njëj' ndërtesë).

Karkashinë : keç o qenjq që nuk' ka ardhur' i mbarë, që nuk' (bën të) rritetë.

Kërrnall : vënt i djegurë nga thatësira; p. sh : Ubë vëndi kërrnall nga të thatëtë.

Konjgjill (shum. konjgjijë) : kokëlë thënjgjilli të ndezurë.

Kërnaçe : kënaçe; bucelë e vogëlë e nigjeshurë me rrip o gjalëmë për t'u mvarur' mbi sup; e përdorin' bujqëtë, barinjët, punëtuarët' të fushësë për të mbajturë ujë të piri.

Këmbac : i zënë nga njëra o nga të dy këmbëtë.

Këmbuc : " " " " " "

Kamës : i pasurë; pasunar.

Kaçkinj : qëronj arrë o mandorle etj.

Kopaçisënj : thyenj (dërrmoj) plisa (buza) me shatënë.

Kukunjë (në shum.) : puçëra që dalin' në trup prej sëmundjeje të gjakutë; koqërina.

Thuhet' edhe për puçërat' që ngrihen' nga të piskuarët' të mishkonjave dhe vizhave t'jera.

Kalbëzhehem : marënj të kalburë; marënj për të kalburë (për t'u kalburë); nisënj (fillonj) të kalbem.

Kalbëshehem :

Kalbëzyerë : (i — —) : që ka nisurë të kalbetë; i marurë të kalbetë.

Kalbësyerë : (i — —) :

Kacan : i shtrënguarë; i kursyerë; i kursejturë; dorështrënguarë; jëkonomitar.

Katarosh edhe katarosh : dhëmp i birë ndënë një dhëmp të jetërë dhe i dalurë shtrëmbërë; stërdhëmp.

Kolloskop : i hyrë dhëndërrë te vjehëri (në shtëpijë të vjehëritë).

Krisje : gram; bar i egërë me rrëzë të thella.

Kolëmë (i — —) : bukurë; i me shijë; i shijëshmë.

Këmbëzë : dredhë (turë) penjësh të qepuri.

Kërkoshanë : luleja e lojfatës' që është si vëthë, e kuqe, dhe pastaj' bëhet' si cironjë, si karumbe të thatë.

Kalepiçë : kalapiçë; kalaqafë.

Kokënjgjymazi : kokëtumba (— bazi); kokëngulëthi.

Lemerijë : e keqe; e zezë; mynxyrë; e stërkeqe; p. sh : Akëcili vajti (vdiq) me lemerijë (— vdiq keq' e tukeqë; hoqi shumë në kohën' kur epte shpirtinë);

Lemerijë që na panë sytë (mynxyrë që pamë me sy).

Leverisem : grisem; bëhem si lëvere; p. sh : Ugrisëm, uleverisëm nëpër pyll; ushqyem e uleverisëm nëpër shkarpë (na mbenë, na mbetën' rrobet' nëpër shkarpë).

Leverisurë (i — —) : i grisurë; i shvaturë; i leckosurë.

Lëveshga : lëfoshka, lëpushka, llapa që mpështjellin' kallirin' e misëritë.

Lipëçar (fem. lipëcare) : lipës; i varfërë.

Laroshem : marënj faqe; skuqem; shehem; piqem (për pemëtë; p. sh : Ularoshën' rrushëtë (qershijatë).

Legendisurë (i — —) : i brengosurë; i mërzhiturë; i shqetësuarë; i helmuarë.

Laraskë : njeri që është me dy faqe; njeri që mbahet' me njëren' anë dhe me t' jetrënë.

Lektisënj : kam mall për një gjë; më hipën malli për një sent (po sidomos për njerëzë); p. sh : Ka lektisur' pas së bijës' së ... ; Lektisën' fëmija për t' ëmënë.

Leshtorëmë (i — —) : leshtuar; i plotë me qime (me les).

Larushk : rrushi i egërë që është për të bërë uthullë; rrushë gardhi.

Laroshurë (i — —) : i marurë faqe; i shejurë; i skuqurë; i pjekurë (për pemëtë).

Larë (— ra) : gunë e dhirtë.

Laragan : që është lara-lara.

Larik : viç lara-lara.

Lariskë : lopë (viçe) lara-lara.

Lloshë (— sha) : lëmishte; të fshira; plehurina shtëpije; sa mer fshesa.

Llozhar : njeriu i lloshave, i lëmishtave, i plehërave; njeri i ndragur' me plehurina, me lëmizhda. **Ay** që mbëledhën të fshiratë dhe plehun' e rrugavetë.

Llosh (— shi) : si dhe lloshë.

Llomé (— ja) : balta (gjana) që lën ujët' të përrenjvet', të rrëkevet' pas një shiu të math; p. sh : Dolli përroj' nga shtrati dhe na mbushi arat' me llomé.

Llump (— mbi; shum. llumbëra) : fundërrirat' (fundrat') të vajitë; llumburtijë.

Llumbëtirë : si dhe llump.

Llamaninj dhe **llamanisënj** : prishënj (trubullonj) gjakunë; pëlçasënj zemrënë; lëndonj në zemërë; mërzhisënj; trazonj; ngacmonj; p. sh : Të lutem mos më llamanis (=të lutem mos më prish gjakunë), Llamanisem; më priset' gjaku; më lëndohet' zemëra.

Llamanijë : helëmë; brengë; andrallë; p. sh : Ajo shtëpijë është plot' llamanijë.

Llamanisurë (i — —) : i brengosurë; i hidhëruarë; i prishurë gjakunë; p. sh: Ajo shtëpijë është e llamanisurë.

Llaturisënj : pëlqënj; përrlyrënj; ndragënj; p. sh : Ullaturis ujëtë (upëlq ujëtë); Ullaturis gjëlla (kur qëllon t' e trazojën' me ndonjë lugë të palarë).

Llaturisurë (i — —) : i pëlqurë; i laturiturë;

Lllallë (— lla) : krimp që prishën bletëtë; thonë se me të hyrë lllalla në krinë gjithë bletët' hikin' dhe e lënë sgjojinë.

Lllallë (— lla) : grindje; ngërrnjë; zihëlë; p. sh : Ka ryrë lllalla në atë shtëpijë.

Lllagarë : i kulluarë; i kthillurë; i qiruarë; p. sh : Ujë lllagarë; Grurë lllagarë.

(ndofta e marur' nga greqishteja).

Llufinj : kollofinj; kallapinj; kllapinj.

Llaskonjë dhe **llasgonjë** : vlladigë; vllaskonjë; lastar; degëzë e re.

Mishtormë (i — —) : njeri i njgjallurë, i plotë në trup; trashaman; bushiq; që ka mish shumë.

Mburusënj : ngarkonj për së tepëri; p. sh : Akëcili e kishte mburusur' kalin' me drù gjer te veshëtë; Akëcila qe mburusur' me shkarpa; E mburusi zjarrin me drù

Mërenem: marënj sy; marënj për sysh; bjenj në sy; p. sh.: I umërye djali (i mori sy, i ra në sy, i ra më sy djali); U mëreva (mora sy; rashë në sy).

Mënjjarash (fem. — she dhe — shkë): ay që bën me krahun' e mëngjërë punët që gjithë bota i bën me të djathtëtinë.

Matkë: bletë e vjetërë 3-4 vjetësh.

Mekëtë (i — —): i paterurë mirë; i patharë mirë.

Magje: govatë për të larë rrobetë.

Govatë për të mbryturë bukënë,

Mbëlatës: vulë e madhe e drunjëtë, e kaliturë me kryqe dhe t'jera shënja të fes' së krishtere, me të cilën' vulosin' bukët' të meshësë.

Muru (— ruri): dorëzë, kapë e thikësë etj. miru.

Myqe (— ja): e trasha e sëpatësë (e sqeparitë); koka e sëpatës (e sqeparitë); myk (— ku).

Mëkonj: apënj të hajë foshnjësë; p. sh.: Fëmijë për të mëkuerë.

Mëzonj: thithënj (thëthinj; pinj) qumështë nga sisa; p. sh.: Foshnja mëzon në gji të s'ëmësë; Ishte tuke mëzuarë; Shqerratë (keçëritë) mëzojnë (sidomos kur u a shtrydhnin' sisën' e s'ëmësë në gojë); Vër-e viçin' të mëzonjë lopënë (= lësho viçin' të zërë sisën' që pastaj' të munt të milet' lopa).

Mëllënkshurë (i — —): qumështë të trashurë.

Mushtuarë (i — —): i pjekurë; i harriturë kohën, më të mirë të jetës' së tijë; p. sh.: Njeri i mushtuarë (njeri i harriturë moshënë, i pjekurë, i stërviturë; i majturë).

Musëndërrë: armar i math i njëjitur' sidomos pas muri.

Mjakem: thahem (sidomos për gojënjë); p. sh.: M'u mjak goja nga të pangrënëjtë; I është mjakurë goja nga zjarri i ethevetë.

Manar (fem. — re): i mësuarë pas një njeriu (pas të zotitë); i sbuturë; i bërë mik; i qepurë pas ndokuj.

Mirosem: venj mbarë; më vete mbarë; p. sh.: Umiros akëcili me martesën' që bëri.

Micë-Micë: nga pak' e nga pakë; mëzë-mëzë; p. sh.: I bën punët micë-micë.

Mbë Cazë: ndajnate; në zëmërëherë; pas dreke.

Nasqerinj dhe nasqerisënj: vënj ç' do sent në vëndin' e tijë; vënj në rjegëllë; p. sh.: Ishte tuke nasqerisur' shtëpijënjë.

Ndjellënj: thërresënj bagëtijënjë, qenetë, kafshë t'jera të mbëlidhenë, të afrohenë.

Zërëra të ndjelluri dhe të përzënnuri për kafshëtë:

për macetë: mac-mac; makërrr-makërrr; pës-pës-pës. (pist-pist; çit; çit-çit).

për qenëtë: na-na; kuët-kuët; për fem. na-buçe-na. (hajt-hajt; osh-t-osht; hosht-hosht).

për kalinë: na-kër-na; rër-na; (dece).

për mushkënjë: na-muçe-na (muç-muç).

për kërrinë (gomarinë): kërr-kërr; kiç-kiç (ysh,ysh).

për pulatë: kërr-kërr-kërr; tigët,tigëti (ush-ush; ço-çoo).

(vijon)